



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



01 Nr. 08/23

Rahovec, 22.8.2023

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e tetë (8), e cila do të mbahet më 30 gusht 2023 (e mërkurë), me fillim në orën 10:00, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të jashtëzakonshme, më datë: 12.7.2023 dhe 17.7.2023;
3. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike P-02302-0, zona kadastrale Rahovec, me pronën e institucioneve qendrore P- 02240-1, zona kadastrale Rahovec, për interes publik;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike P-05537-1, zona kadastrale Rahovec, me pronën private P-05539-0, zona kadastrale Rahovec, për interes publik;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike P-01505-0, zona Kadastrale Retijë, me pronën e institucionit qendror P- 00050-0, zona kadastrale Opterushë, për interes publik;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike P-01505-0, zona Kadastrale Retijë, me pronën e institucionit qendror P-01987-0, zona kadastrale Opterushë, për interes publik;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronave publike P-01313-1, P01313-2, P01313-4, P-01313-5, zona kadastrale Rahovec, me pronën private P- 01313-3, zona kadastrale Rahovec, për interes publik;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike P-01015-1, zona kadastrale Xërxë, me pronën private P-01015-12, zona kadastrale Xërxë, për interes publik;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për faljen e borxhit mbi tatimin në pronë;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit të Planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së, për vitin 2022;
12. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për përfshirjen e komunitetit rom dhe ashkali 2023-2025;



KRYESUES I KUVENDIT

Arbër Zenuni



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 4 paragrafi 1 pika 1.5 lidhur me nenin 14, paragrafi 1, pika 1.7 i Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, Strategjisë për përfshirjen e Komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2022 – 2026, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 40, paragrafi 2, pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 00.08.2023, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit të veprimit për përfshirjen e komunitetit rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare – Komuna Rahovec 2023-2025

1. Me këtë vendim, **miratohet** Plani i veprimit për përfshirjen e komunitetit rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare – Komuna Rahovec 2023-2025.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i veprimit për përfshirjen e komunitetit rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare – Komuna Rahovec 2023-2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës dhe Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete në Komunën Rahovec.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës Rahovec, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **Kryetarit të Komunës,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/23
Datë:00.08.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA E KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINETI PREDSEDUE OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunes)
Nr./Br./No 1092 Nr. i faq./Br.str./No.pg 1
Data/Datum/Date 9 / 8 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

KOMUNA/MUNICIPALITY / OPŠTINA

RAHOVEC / ORAHOVAC



**ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM
OPŠTINSKA KANCELARIJA ZA ZAJEDNICE I POVRATAK
OFFICE FOR COMMUNITIES AND RETURN**

PLANI I VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN E KOMUNITETIT ROMË DHE ASHKALI NË SHOQËRINË KOSOVARE- KOMUNA RAHOVEC 2023-2025

Qershor 2023

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
1. HYRJE	4
1.1. Metodologjia.....	5
2. ANALIZA E GJENDJES	7
2.1. Arsimi.....	7
2.2. Punsim dhe Mirqenja Sociale	8
2.3. Shëndetësia.....	9
2.4. Banimi.....	9
2.5. Diskriminimi	9
3. OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET	10
3.1. Arsimi.....	10
3.1.1. Sfidat kryesore	10
3.1.2. Rezultatet e pritshme.....	11
3.1.3. Përshkrimi i aktiviteteve.....	11
3.1.4. Supozimet dhe rreziqet	14
3.2. Punsim dhe Mirqenja Sociale	14
3.2.1. Sfidat kryesore	14
3.2.2. Rezultatet e pritshme.....	15
3.2.3. Përshkrimi i aktiviteteve.....	15
3.2.4. Supozimet dhe rreziqet	18
3.3. Shëndetësia.....	18
3.3.1. Sfidat kryesore	18
3.3.2. Rezultatet e pritshme.....	19
3.3.3. Përshkrimi i aktiviteteve.....	19
3.3.4. Supozimet dhe rreziqet	20
3.4. Banimi.....	21
3.4.1. Sfidat kryesore	21
3.4.2. Rezultatet e pritshme.....	21
3.4.3. Përshkrimi i aktiviteteve.....	22
3.4.4. Supozimet dhe rreziqet	23
3.5. Diskriminimi	21
3.4.1. Sfidat kryesore	21
3.4.2. Rezultatet e pritshme.....	21
3.4.3. Përshkrimi i aktiviteteve.....	22
3.4.4. Supozimet dhe rreziqet	23

4. BUXHETI.....	23
5. PLANI I ZBATIMIT	26
SHTOJCA 1	36
GRUPI PUNUES.....	36

SHKURTESAT

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DKRS	Drejtorja për Kulturë, Riçi dhe Sport
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
IP	Institucionet Parashkollore
MASht	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë
MSh	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PLV	Plani Lokal i Veprimit
PRTAN	Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QM	Qendra Mësimore
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
SWOT	Sukseset, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
OSCE	Organizata për Siguri dhe bashkëpunim me Europë

1. HYRJE

Strategjia për përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare - 2023-2025, paraqet një vazhdimësi të politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërtimin e një shoqërie shumetnike dhe krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve. Kjo Strategji synon të plotësojë hendekun e komuniteteve rom dhe ashkali, që përfshinë por nuk kufizohet në fushat e: arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë, banimit dhe diskriminimit.

Strategjia për përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali - 2022-2026 është paraparë në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021–2025¹ dhe në Planin Strategjik Operativ (PSO) të Zyrës së Kryeministrit. Kjo Strategji është hartuar nën udhëheqjen e Zyrës për Qeverisje të Mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Gjatë hartimit të Strategjisë janë marrë parasysh mësimet e nxjerra nga raporti i zbatimit të Strategjive paraprake për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë,² Korniza e BE-së për Integrimin e Romëve,³ Programi i Qeverisë, Anketat e Grupimeve të Treguesve të

¹ Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021–2025, maj 2021.

² Strategjia për përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali 2017-2021, Qeveria e Republikës së Kosovës, Zyra e Kryeministrit-Zyra për Qeverisje të Mirë, Prishtinë, Prill 2017 (Në tekstin e mëtejshëm: Strategjia për përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali 2017-2021) si dhe Strategjia për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009- 2015, Qeveria e Republikës së Kosovës, Zyra e Kryeministrit-Zyra për Qeverisje të Mirë, Prishtinë, Dhjetor 2008 (Në tekstin e mëtejshëm: Strategjia për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009- 2015). Siç vërehet në Strategjinë e Qeverisë së Republikës së Kosovë të miratuar në dhjetor të vitit 2008, kanë qenë të përfshirë edhe komuniteti Egjiptianë, më pastaj përfaqësuesit e komunitetit egjiptianë nuk kanë dëshiruar që të jenë pjesë e kësaj strategjie. Duke respektuar vullnetin e përfaqësuesve të këtyre komuniteteve, që nga Strategjia e Qeverisë së Republikës së Kosovës e miratuar në prill të vitit 2017, komuniteti egjiptian nuk janë përfshirë në Strategji duke përfshirë edhe këtë Strategji. Romët, ashkalitë dhe egjiptianët e Kosovës janë tri komunitete të veçanta. Megjithatë, të tri këto komunitete përballen me pengesa dhe sfida të ngjashme, në kuptim të përfshirjes së tyre në shoqëri. Të vetëdijshëm që në shumë situata, komuniteti egjiptianë përballen me problemet dhe sfidat e komuniteteve rom dhe ashkali, dhe duke marrë parasysh që jo rrallë është shumë e vështirë që të bëhet një ndarje të problemeve dhe sfidave të këtyre tri komuniteteve, megjithatë është respektuar vullneti përfaqësuesve të komunitetit egjiptianë dhe fokus i kësaj strategjie janë komunitete rom dhe ashkali.

³ Korniza e BE-së për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve deri në vitin 2020-2030, Bruksel, 07.10.2020, COM (2020) 620. Në kontekstin kosovar, në kuadër të termit të gjerë gjithëpërfshirës "Roma", sipas Kornizës së BE-së për Integrimin e Romëve, këtu përfshihen romët, ashkalitë dhe egjiptianët.

Shumëfishtë (MICS), për komunitetet rom dhe ashkali në Kosovë, të realizuar në 2019-2020 nga ASK,⁴ si dhe legjislacioni dhe dokumentet dhe strategjitë tjera sektoriale.

Në bazë të Kornizës BE-së për Integrimin e Romëve, janë definuar pesë fusha të veprimit të cilat duhet të adresohen nga Strategjia: arsimi, punësimi dhe mirëqenia sociale, shëndetësia, banimi dhe diskriminimi. Këto fusha paraqesin prioritetet me të cilat duhet të ballafaqohet Strategjia, dhe ndër veprojnë me njëra tjetrën. Në shumicën e rasteve paraqesin edhe shkaqe edhe rrjedhoja apo efekte të njëra-tjetrës, prandaj është jetike të punohet në secilën në mënyrë që të arrihen rezultate efektive.

Në përputhje me Marrëveshjet e Bashkëpunimit me donatorët përkatës, Komuna e Rahovecit dhe donatorët, kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm, përkatësisht, themelimin e Grupit punues nga Komuna dhe caktimin e punëtorive që janë përkrahur nga OSCE - ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM ME EUROPE.

Sipas statistikave nga regjistrimi i popullsisë i bërë në vitin 2011⁵, dhe të konfirmuara nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK në komunën e Rahovecit jetojnë 787 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian , 134 Serbë sipas regjistrimit zyrtar (ndersa me informata sipas statistikave të ZKKK-së rreth 700 serbë) , Boshnjak etj .

Në komunën e Rahovecit, banorët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian jetojnë kryesisht në qytetin e Rahovecit (rreth 260 pjesëtarë), dhe me numër më të madh në fshatrat: Xërxë, Ratkoc, Krushë e Madhe, Dabidol, Çifllak, Celinë etj, ndërsa komuniteti Serbë me 550 banor në fsh .Hoqë e Madhe dhe 134 në qytet (lagja e epërm).

1.1. Metodologjia

Pas themelimit të grupit punues nga Komuna dhe konsulencës së vazhdueshme nga ZKKK dhe OSCE, janë zhvilluar disa takime konsultative dhe dy punëtori. Më poshtë do të paraqesim ecurinë e procesit si dhe një përshkrim të metodologjisë së punës për hartimin e PLANIT TË VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË SHOQËRINË KOSOVARE 2023-2025.

Fillimisht , janë zhvilluar takime me përfaqësuesit e Komunës, kryesisht mes ZKKK-së, Komitetin për Komunitete, Banorëve dhe përfaqësuesve të komuniteteve, me qëllim të mbledhjes së informatave relevante që do të ndihmojnë në hartimin e Planit. Pas takimeve konsultative, është zhvilluar punësoria e parë me grupin punues të caktuar nga Komuna për të prezantuar të dhënat e gjetura dhe për të përcaktuar fushëveprimin e Strategjisë.

Megjithatë STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË SHOQËRINË KOSOVARE 2023-2025 , ka identifikuar pesë fusha kryesore, atëherë edhe grupi punues ka vendosur që për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Rahovecit të ketë këto pesë fusha kryesore:

⁴ MICS për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ASK, 2020.

⁵ <http://ask.rks-gov.net/>

1. ARSIMI
2. PUNËSIM DHE MIRQENJA SOCIALE
3. SHËNDETËSIA
4. BANIMI
5. DISKRIMINIMI

Pas përcaktimit të fushëveprimit, janë zhvilluar disa punëtori njëditore me grupin e gjerë, një takim me pjestarët e komuniteteve rom , ashkali dhe egjiptian , përfshirë edhe ojq-tëaktive , për të analizuar gjendjen ekzistuese.

Për të arritur objektivat e kësaj punëtorie është përdorë Analiza SËOT, ku gjatë 2 sesioneve është bërë analiza e gjendjes nga secila fushë e paracaktuar e strategjisë. Kontributet e nxjerra nga analiza SWOT janë përmbledhur në tabela specifike për secilën fushë dhe janë shfrytëzuar si udhërrëfyes për përshkrimin e gjendjes aktuale. Në përfundim të punëtorisë janë përcaktuar objektivat dhe aktivitetet e strategjisë . Punëtorja ka filluar me një validim të të gjeturave nga analiza e gjendjes dhe pastaj janë përcaktuar objektivat kryesore strategjike, rezultatet dhe aktivitetet përkatëse.

Cikli i punëtorive është përmbyllur me punëtorinë njëditore për finalizimin e strategjisë dhe përcaktimit të kostos buxhetore për zbatimin e tij.

2. ANALIZA E GJENDJES

Punëtorja e parë për hartimin e Strategjisë ka pasur për qëllim analizën e gjendjes së komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian në komunën e Rahovecit në fushat e përmendura më lartë:

Sipas statistika-nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK në komunën e Rahovecit jetojnë rreth 8-4 pjesëtarë të komunitetit rom, 404 pjesëtarë të komunitetit ashkali dhe 299 pjesëtarë të komunitetit egjiptian .

Në komunën e Rahovecit banorët e komunitetit rom dhe ashkali jetojnë kryesisht në qytetin e Rahovecit (84 anëtarë të komunitetit rom dhe 186 anëtarë të komunitetit ashkali), ndërsa komuniteti egjiptian në masë të madhe jeton në fshatin Ratkoc dhe Xërxë, përkatësisht 100 në Ratkoc dhe 72 në Xërxë. Pra ajo që vërehet është se pjesëtarët e këtyre komuniteteve nuk jetojnë në vendbanime jo-formale dhe kolektive, por janë të shtrirë në disa fshatra.

Statistikat që janë paraqitur në këtë Plan janë të Regjistrimit të Popullsisë të bëra në vitin 2011, por në disa statistika mbi banorët e komunitetit serbë ZKKK posedon statistika të tjera mbi situatën e këtyre komuniteteve (përshkak të mos regjistrimit në atë të fundit në 2011 si pasojë e ndikimit politik)

2.0. Arsimi

Në Komunën e Rahovecit përfshirja e fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar mbetet në nivel jo të kënaqshëm.

Sipas statistikave zyrtare nga MASHT/SMIA dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin shkollor 2022/23 nuk ka pasur asnjë fëmijë/nxënës nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të përfshirë në edukimin parashkollor në Komunën e Rahovecit.

Sfidë e madhe në Komunën e Rahovecit mbetet mungesa e të dhënave zyrtare se sa është numri i fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që nuk janë të përfshirë në secilin nga nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar, prandaj dhe është e pamundur që të konstatohet me saktësi për nivelin e përfshirjes.

Është me rëndësi të përmendet që përveç faktorëve të tjerë, përfshirjes së ulët të fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e

edukimit/arsimit parauniversitar në Komunën e Rahovecit i kontribuon edhe gjendja e rëndë socio-ekonomike e familjeve të këtyre komuniteteve.

Përveç nivelit jo të kënaqshëm të përfshirjes së fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar, shqetësim tjetër konsiderohet edhe suksesi jo i mirë i nxënësve të këtyre komuniteteve krahasuar me mesataren e suksesit të përgjithshëm të nxënësve të komunitetit shumicë, megjithëse për këtë nuk ka statistika të sakta zyrtare.

Analiza SËOT e zhvilluar gjatë punëtorisë nxjerr në pah edhe shumë faktorë të tjerë të cilët në mënyra të ndryshme ndikojnë në gjendjen aktuale të arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Rahovecit.

2.1. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Papunësia në Kosovë sipas të dhënave të fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës është 32.9%. Raportet e fundit të publikuar nga ASK dhe nga hulumtime të ndryshme tregojnë që shkalla e papunësisë te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është shumë më e madhe se sa vlerat në nivel vendi.

Përveç shkaktarëve të përgjithshëm që ndikojnë në nivelin e lartë të papunësisë, ka edhe shkaktarë të veçantë që i kontribuojnë papunësisë së madhe të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Rahovecit. Njëri nga këta shkaktar është mungesa e kuadrove me kualifikime universitare nga radhët e këtyre komuniteteve, gjë që pamundëson ose vështirëson punësimin e tyre në mungesë të plotësimit të kriterëve ligjore, posaçërisht në sektorin publik, sidomos deri në arritjen e plotësimit të kuotave për punësimin e komuniteteve që parashihen me ligj.

Komuna e Rahovecit në bashkëpunim edhe me partnerë dhe donatorë të ndryshëm ka ofruar mundësi për përfshirjen e punëkërkuesve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në tregun e punës, qoftë përmes ofrimit të trajnimeve apo edhe përkrahjes së planeve të bizneseve.

Niveli i lartë i papunësisë së pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Rahovecit, ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në mirëqenien sociale të tyre. Kjo ka bërë që një numër i madh i familjeve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të jenë përfitues të skemave sociale.

Analiza SËOT e zhvilluar gjatë punëtorisë nxjerr në pah edhe shumë faktorë të tjerë të cilët në mënyra të ndryshme ndikojnë në gjendjen e rëndë ekonomike dhe sociale të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

2.2. Shëndetësia

Shërbimet shëndetësore në Komunën e Rahovecit kanë një shtrirje të gjerë dhe mbulojnë mjaft mirë të gjithë territorin e komunës. Kjo komunë përveç Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) disponon edhe disa Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF).

Mbetet shqetësuese vetëdija e përgjithshme e popullatës nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian përsa i përket sëmundjeve të ndryshme ngjitëse, dhe vaksinimit të fëmijëve. Në Komunën e Rahovecit, përmes projekteve të ndryshme nga OShC-të dhe donatorët janë zhvilluar një varg i aktiviteteve të cilat kanë pasur një rol të rëndësishëm në mobilizimin e popullatës për të shfrytëzuar shërbimet shëndetësore, me theks të veçantë në aspektin parandalues të sëmundjeve të ndryshme, si dhe vaksinimit të fëmijëve.

Analiza SËOT e zhvilluar gjatë punëtorisë nxjerr në pah edhe shumë faktorë të tjerë të cilët në mënyra të ndryshme ndikojnë në shëndetin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Rahovecit.

2.3. Banimi

Gjendja në Komunën e Rahovecit përsa i përket çështjes së banimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në mënyrë të vazhdueshme është përmirësuar. Megjithatë, një numër i familjeve kanë probleme me kushte të vështira të banimit, kanë mungesë të pronave për ndërtim të shtëpive, kanë probleme me dokumentacion të pronës.

Është me rëndësi të përmendet se përkeqësimit të situatës jo të mirë sa i përket banimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Rahovecit i ka kontribuar edhe migrimi i disa familjeve në vendet tjera, të cilat i kanë shitur apo i kanë lëshuar pronat ku kanë banuar dhe tani që ri-kthehen apo ri-atdhesohen nuk kanë më prona apo hapësira për banim.

2.4. Diskriminimi

Diskriminimi: Diskriminimi është prezent në gjithë popullatën, sidomos në aspektin gjimorë, po edhe numri i romëve dhe ashkalive, që në situatë shoqërore ndihen të diskriminuar për shkak të përkatësisë së tyre etnike është më shumë prezent, sesa tek pjesa tjetër e popullsisë, prandaj ky fenomen kërkon trajtim më afatgjatë. Korriza e BE-së për Integrimin e Romëve, në të cilën bazohet edhe kjo Strategji, përkufizon luftimin e diskriminimit si: luftimin e diskriminimit, ngacmimit, krimit të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes kundër romëve (lexo: dheashkalive); promovimin (ndërgjegjësimin) e historisë, kulturës, njohjes dhe pajtimit të romëve (lexo: dhe ashkalive).

Diskriminimi, është një fenomen që është prezent në fushën e arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë, dhe banimit, ku do të trajtohet në këto katër fushat, duke vendosur objektiva specifike të veçanta që i dedikohen diskriminimit.

Për secilën nga pesë fushat e Strategjisë është definuar një objektiv strategjik. Secili objektiv strategjik është zbërthyer në objektiva specifike, ndërsa këto objektiva specifike më tutje në Planin e Veprimit janë zbërthyer në rezultate dhe në aktivitete.

3. OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Siç është paraqitur në analizën e gjendjes, ky plan i veprimit do t'i ketë 5 fusha kryesore të bazuara edhe në Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare në nivel qendror.

Për secilën nga këto fusha është përcaktuar një objektivë strategjike, ndërsa për çdo objektivë janë përcaktuar rezultatet të cilat do të arrihen duke i zbatuar aktivitetet specifike.

Më poshtë do të paraqiten objektivat strategjike, rezultatet dhe aktivitetet për secilën fushëveprim të Planit të Veprimit.

3.1. Arsimi

Është vërtetuar botërisht që ndryshimet në arsim i paraprijnë edhe ndryshimeve shoqërore. Duke u nisur nga kjo paradigmë, fusha e arsimit ka zënë një vend shumë të rëndësishëm në këtë Plan të veprimit.

Marrë për bazë situatën aktuale në fushën e arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Rahovecit, ky Plan i Veprimit parasheh një varg të aktiviteteve që duhet të ndërmerren për të avancuar pozitën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushën e arsimit.

3.1.1. Sfidat kryesore

Nga analiza e gjendjes që është bërë në kuadër të fushës së arsimit kanë dalë këto sfida kryesore:

- Vetëdijesimi i pamjaftueshëm i komunitetit për rëndësinë e shkollimit dhe bashkëpunimit me institucionet arsimore
- Braktisja / mos-regjistrimi i shkollimit nga ana e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në mënyrë të veçantë mos-regjistrimi i shkollimit të mesëm të lartë nga vajzat
- Mos-përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor
- Përkrahja e pamjaftueshme për zbatimin e metodave të reja në klasë që do të ndihmonte në përfshirjen sa më të madhe të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Objektiva strategjike 1

Për të siguruar adresim të mirëfilltë të sfidave të renditura më lartë në fushën e arsimit është përcaktuar ky objektiv strategjik:

Objektivi 1: Rritja e bashkëpunimit ndër-sektorial në funksion të përfshirjes dhe ofrimit të mundësive për zhvillim, aftësim dhe arsimim cilësor për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

3.1.2. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan Veprimi për fushën e arsimit parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- **Rezultati 1.1.** Përmirësohet qasja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim
- **Rezultati 1.2.** Ndërgjegjësohen palët e interesit për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
- **Rezultati 1.3.** Sigurohet qasje në arsim për të gjithë fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të ri-atdhesuar

3.1.3. Përshkrimi i aktiviteteve

REZULTATI 1.1:	Përmirësohet qasja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 1.1.1 Identifikimi i nevojave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushën e arsimit, mirëqenies sociale, shëndetësisë dhe banimit	ZKKK në bashkëpunim me donatorët, zhvillojnë një hulumtim të nevojave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushën e arsimit, mirëqenies sociale, shëndetësisë dhe banimit. Hulumtimi zhvillohet dhe koordinohet nga ZKKK. Ky aktivitet i paraprin të gjitha intervenimeve që do të bëhen në kuadër të këtij Plani. Të dhënat nga ky hulumtim do të analizohen dhe do të shfrytëzohen nga të gjitha institucionet në nivel komunal.
Aktiviteti 1.1.2 Identifikimi i fëmijëve në nevojë dhe sigurimi i mjeteve arsimore	ZKKK në bashkëpunim me DKA dhe QPS, bëjnë identifikimin e familjeve që kanë gjendje të rëndë ekonomike dhe që kanë fëmijë të moshës së arsimit të detyruar. Fëmijët e identifikuar duhet të pajisen me pako shkollore së paku një herë në vit. Përveç përkrahjes me pako shkollore nga vet komuna, institucionet përgjegjëse mund të kërkojë edhe ndihmën e donatorëve dhe të bizneseve private për t'i përkrahur këta nxënës me pako shkollore apo edhe me veshmbathje.
Aktiviteti 1.1.3 Organizohet mësimi intensiv për fëmijët që kanë vonesa në shkollimin e obliguar	DKA, ZKKK dhe shkollat në bashkëpunim MASHT dhe OJQ-të do të bëjnë identifikimin e të gjithë fëmijëve që kanë vonesa në shkollimin e obliguar. Duke u bazuar në gjendjen ekzistuese dhe në trendin e kthimit / ri-atdhesimit të familjeve nga vendet e ndryshme, supozohet që brenda 1 viti shkollor rreth 5 fëmijë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian do të përfitojnë

	mësimi intensiv. Mësimi intensiv do të aplikohet gjatë viteve të zbatimit të këtij Plani të Veprimit me qëllim të përfshirjes së të gjithë fëmijëve. Megjithatë, do të maksimizohen mundësitë që rastet që kanë mundësi, të përfshihen në sistemin e rregullt shkollor.
Aktiviteti 1.1.4 Krijimi i ambienteve të sigurta dhe atraktive në shkolla	DKA dhe shkollat në bashkëpunim edhe me OJQ-të dhe donatorët ndërmarrin aktivitete për të përmirësuar sigurinë e fëmijëve në shkolla. Me theks të veçantë shkollat me përkrahjen e DKA-së zbatojnë politika dhe aktivitete për parandalimin e dhunës në shkolla ku mund të përfshihen fëmijët nga grupet e cënueshme.
Aktiviteti 1.1.5 Organizimi i trajnimeve kundër diskriminimit dhe paragjyqimeve / Organizimi i trajnimeve kundër braktisjes së shkollës	DKA në bashkëpunim me donatorët dhe me OSHC-të që ofrojnë trajnime të kësaj natyre, organizojnë trajnime periodike kundër diskriminimit dhe paragjyqimeve për mësimdhënësit që punojnë me fëmijë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Po ashtu, organizohen trajnime për Ekipet Shkollore kundër braktisjes. Trajnimet e tilla do ti përgatisin mësimdhënësit që të krijojnë një ambient miqësor dhe përkrahës për të gjithë fëmijët në klasë, pa kurrfarë dallime. Po ashtu, këto trajnime do të ndihmojnë mësimdhënësit që të krijojnë klasa gjithëpërfshirëse, duke përmbytur nevojat e të gjithë nxënësve në klasë.
Aktiviteti 1.1.6 Identifikohen dhe adresohen rastet e braktisjes së shkollimit nga nxënësit	DKA në bashkëpunim me shkollat duhet të shfrytëzoj sistemin e raportimit të të gjitha rasteve të braktisjes dhe të atyre që janë në rrezik të braktisjes i cili është i integruar në Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim -SMIA. Secili raportim duhet të merret seriozisht dhe të trajtohet nga Ekipet për Parandalim të Braktisjes në nivel të shkollave dhe në nivel të Komunës. Po ashtu, në trajtimin e këtyre rasteve mund të kontribuojnë edhe akterët tjerë, siç janë: OJQ-të, Qendra për Punë Sociale dhe Qendrat e Komuniteteve.
Aktiviteti 1.1.7 Monitorimi i suksesit dhe qëndrueshmëria e intervenimit	ZKKK në bashkëpunim me DKA dhe me shkollat monitorojnë suksesin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të cilët janë përfitues të skemave të ndryshme përkrahëse (përfituesit e bursave, përfituesit e pakove shkollore, përfituesit e mësimi intensiv). Në baza vjetore hartohet një raport i cili shpërndahet tek sektorët përgjegjës
REZULTATI 1.2:	Ndërgjegjësohen palët e interesit për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Aktiviteti 1.2.1 Organizimi i fushatave vetëdijësuese për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për rëndësinë e shkollimit	ZKKK dhe DKA, në bashkëpunim me shkollat, si dhe me përkrahjen e OShC-ve dhe donatorëve të ndryshëm organizojnë fushata vetëdijësuese për familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Fushatat mund të bëhen në formë të kampanjave të ndryshme mediale, takime formale dhe jo-formale, organizimin e tryezave të diskutimit etj. Përveç fushatave informuese, këtu mund të përfshihen edhe studentë nga komunitet rom, ashkali dhe egjiptian apo edhe personalitete të suksesshme të cilat do ti tregojnë storiet e tyre të suksesit përmes vizitave nëpër familje, apo edhe përmes organizimit të sesioneve të ndryshme informative. Fushatat dhe sesionet informuese organizohen në prag të konkurseve të shpallura nga shkollat dhe institucionet tjera arsimore.
Aktiviteti 1.2.2 Organizimi i Kampeve verore	ZKKK, DKA, DKRS në bashkëpunim edhe me shkollat, si dhe me përkrahjen e OShC-ve dhe donatorëve të ndryshëm organizojnë Kampe verore për fëmijët dhe prindërit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, me qëllim të motivimit të nxënësve dhe prindërve për përfshirjen në arsim. Kampet organizohet njëherë në vit gjatë periudhës kur janë afatet për regjistrim në shkollë fillore dhe të mesme të lartë.
Aktiviteti 1.2.3 Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta prind-komunitet-shkollë	ZKKK, DKA, DKRS në bashkëpunim edhe me shkollat, si dhe me përkrahjen e OShC-ve dhe donatorëve të ndryshëm organizojnë Aktivitete për fëmijët dhe prindërit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, me qëllim të motivimit të nxënësve dhe prindërve për përfshirjen në arsim. Aktivitetet organizohen gjatë periudhës kur janë afatet për regjistrim në shkollë fillore dhe të mesme të lartë apo edhe duke shënuar Festat dhe Ditët e ndryshme Ndërkombëtare (p.sh. 1 Qershori - Dita e Fëmijëve; Dita Ndërkombëtare e leximit - 8 shtator; Muajt të Rinisë etj.)
REZULTATI 1.3:	Sigurohet qasje në arsim për të gjithë fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të ri-atdhesuar
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 1.3.1. Identifikohen dhe adresohen rastet e fëmijëve të ri-atdhesuar	ZKKK në bashkëpunim me sektorët tjerë në nivel komune, identifikon familjet e ri-atdhesuara të cilat kanë fëmijë të moshës shkollore. Pas identifikimit, ZKKK ndërmerr të gjithë hapat për të adresuar në mënyrën më të mirë nevojat e këtyre familjeve. ZKKK krahas përkrahjes që ofron në kuadër të politikave të ri-atdhesimit, do të ofrojë edhe përkrahje shtesë për fëmijët e moshës shkollore p.sh. përkrahje për t'u pajisur me

dokumentacionin përkatës, përkrahje për të nostrifikuar dokumentet. Kjo përkrahje nënkupton mbulimin e shpenzimeve financiare për këto shërbime dhe për vajtje-ardhje në MASHT/Prishtinë. Supozohet që brenda një viti mund të ketë 10 raste të tilla.

3.1.4. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 1 të paraparë me këtë dokument janë:

- Të gjitha palët e përfshira kanë vullnet dhe angazhohen për rritjen e nivelit të përfshirjes, zvogëlimin e rasteve të braktisjeve të shkollimit dhe përmirësimin e suksesit të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar, duke i realizuar aktivitetet e parapara me këtë dokument;
- MASHT tregon përkushtim për përfshirjen në mësim intensiv të fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që kanë vonesa në shkollimin e obliguar
- Mësimdhënësit e trajnuar do të zbatojnë metoda dhe teknika në procesin mësimor për të siguruar një ambient mik për të gjithë fëmijët, pa dallime

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 1 të paraparë me këtë dokument janë:

- Mos gatishmëria e shkollave për të zbatuar politikat anti-diskriminuese
- Mungesa e buxhetit nga MASHT për përkrahje të mësimin intensiv
- Mosgatishmëria e komunitetit për të bashkëpunuar me institucionet për të adresuar problemet e përfshirjes në arsim

3.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Gjatë punës për hartimin e këtij Plani të Veprimit është konstatuar se përmirësimet në këtë fushë do të kenë ndikim shumë të madh në përmirësimin e mirëqenies sociale; do të motivoj të rinjtë që t'i kushtojnë më shumë rëndësi shkollimit, rrjedhimisht, shumë probleme të identifikuara në kuadër të këtij Plani do të adresoheshin apo zgjidheshin.

Marrë parasysh rëndësinë që kanë intervenimet në këtë fushë, Punësimi dhe mirëqenia sociale është përmbledhur në një objektiv strategjik të Planit, që parasheh ndërmarrjen e disa veprimeve që do të ndikonin në përmirësimin e gjendjes ekonomike-sociale të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

3.2.1. Sfidat kryesore

Nga analiza e gjendjes që është bërë në kuadër të kësaj fushe, janë identifikuar një numër i madh i sfidave me të cilat ballafaqohet ky sektor. Më poshtë do të paraqesim disa prej sfidave

që janë konsideruar si prioritare për t'u adresuar brenda periudhës zbatuese të Planit të Veprimit:

- Niveli i ulët i punësimit nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
- Mungesa e shkollimit dhe kualifikimeve adekuate, iu vështirëson gjetjen e vendeve të punës
- Kufizimet buxhetore të Komunës, pamundësojnë ofrimin e shërbimeve sociale për të gjitha rastet në nevojë nga komunitetet.
- Kriteret për përfitim të asistencës sociale janë shumë të ashpra, dhe në shumë raste edhe joadekuate për nevojat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Objektiva strategjike 2

Për të siguruar adresim të mirëfilltë të sfidave të renditura më lartë në fushën e punësimit është përcaktuar ky objektiv strategjik:

Objektivi 2: Përmirësimi i mirëqenies dhe standardit jetësor përmes sigurimit të punësimit të qëndrueshëm dhe shërbimeve sociale efikase

3.2.2. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan Veprimi për fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- **Rezultati 2.1.** Përmirësohet përfshirja e pjesëtareve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në punësim
- **Rezultati 2.2.** Përmirësohet pjesëmarrja në skemat sociale e familjeve në nevojë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

3.2.3. Përshkrimi i aktiviteteve

REZULTATI 2.1:	Përmirësohet përfshirja e pjesëtareve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në punësim
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Aktiviteti 2.1.1 Fushatë informuese dhe avokuese për respektim të kuotës së punësimit për komunitetet	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit si dhe me përkrahjen e OShC-ve dhe donatorëve të ndryshëm organizojnë fushatë avokuese në nivel komunal për të avancuar zbatimin e kuotës së punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo fushatë do të koordinohet nga ZKKK dhe ka për qëllim informimin e të gjitha institucioneve në nivel komune, bizneseve, punëdhënësve potencial, por edhe publikut në përgjithësi për kuotat e përcaktuara me ligj për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve. Pjesë integrale e kësaj fushate do të jetë edhe Inspektorati i Punës, të cilët do të informonin të punësuarit për dëmet dhe pasojat e ekonomisë informale.
Aktiviteti 2.1.2 Identifikimi i fuqisë punëtore nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (i të papunëve dhe punëkërkuësve) dhe ofrimi i këshillave për punësim	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit bënë identifikimin e fuqisë punëtore nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (i të papunëve dhe punëkërkuësve) dhe harton një databazë. Në bazë të nevojës harton plane përkrahëse këshilluese. ZKKK ndërmjetëson në raste të ndryshme me qëllim të rritjes së punësimit të përfaqësuesve të komuniteteve.
Aktiviteti 2.1.3 Ofrimi i kurseve shtesë për aftësim profesional dhe kurseve artizanale për punëkërkuësit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit bënë identifikimin e të gjithë punëkërkuësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Në koordinim të ngushtë me Qendrat për Aftësim Profesional, dukeu bazuar në nevojat e punëkërkuësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, harton plane për përfshirjen në kurse për aftësim profesional. ZKKK dhe Zyra e punësimit mund të gjejnë alternativë për organizimin e këtyre kurseve nga QAP-at e tjera. Kjo mund të bëhet duke organizuar transportin për të interesuarit, deri tek QAP-at nga qytetet tjera. Supozohet që brenda një viti, mund ti kemi 5 raste të tilla.
Aktiviteti 2.1.4 Përkrahje për të rinjtë nga komunitetet për të hapur biznese të reja	Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me donatorët potencial ofrojnë mundësi aplikimi për të rinjtë nga komunitetet që kanë përfunduar shkollimin e lartë, me ide për start-up biznese. Praktikat e deritanishme kanë treguar që komuniteti i donatorëve është i interesuar për të përkrahur krijimin e bizneseve të reja. Komuna do të shfrytëzoj këto mundësi duke participuar me mjete vetanake në nisma të tilla.

REZULTATI 2.2:	Përmirësohet pjesëmarrja në skemat sociale e familjeve në nevojë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 2.2.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të familjeve në nevojë për përfshirje në skemat sociale	Në Komunën e Rahovecit ka pasur raste, kur familjet në nevojë për shkak të neglizhencës kanë humbur asistencën sociale, apo nuk janë fare përfitues të skemave sociale. Kjo ka ardhur si pasojë e mosinformimit të familjeve me kushtet, procedurat dhe kriteret për të qenë përfitues i skemave sociale. Për të shmangur situata të tilla, ZKKK, DShMS dhe QPS në bashkëpunim me OShC-të identifikojnë nevojat e të gjitha familjeve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që kanë nevojë për tu përfshirë në skema sociale. Sipas nevojave të identifikuara, DShMS dhe QPS do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për ti përfshirë në skemat sociale familjet në nevojë. Theks i veçantë do të kushtohet familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara.
Aktiviteti 2.2.2 Parandalimi i punëve të rënda dhe mbrojtja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian	Rastet e shumta të shfrytëzimit të fëmijëve qoftë për punë të rënda apo edhe shfrytëzimit të tyre për të kërkuar lëmshë, obligojnë institucionet lokale që të zbatojnë masa për parandalimin e keqpërdorimit të fëmijëve. ZKKK do të ketë rol monitorues dhe mobilizues për të njoftuar institucionet dhe mekanizmat tjerë, në mënyrë që të parandalohet çdo keqpërdorim i fëmijëve të komuniteteve qoftë nga familja, apo grupet tjera të interesit.
Aktiviteti 2.2.3 Koordinim i shtuar në mes sektorëve komunal për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në punësim dhe shërbime sociale	ZKKK do të themelojë një mekanizëm komunal ndërsektoral që do të ketë për mandat koordinimin e të gjithë akterëve për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në punësim dhe shërbime sociale. Në këtë mekanizëm do të bëjnë pjesë: ZKKK (koordinator), DShMS, QPS, Zyra e punësimit, DKA, OJQ-të, bizneset etj. Varësisht nga nevojat, ky mekanizëm mund të zgjerohet edhe me përfaqësues nga palët me interes.
Aktiviteti 2.2.4 Organizim i takimeve periodike për	ZKKK si koordinatore e Grupit koordinues do të organizojë takime periodike (2 herë në vit) për të siguruar që janë ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të

koordinim në mes
të sektorëve

komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në punësim dhe shërbime sociale.

Varësisht nga nevoja, ky Grup mund të takohet edhe më shpesh për të trajtuar çështjet dhe sfidat që paraqiten.

3.2.4. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 2 të paraparë me këtë dokument janë:

- Të gjitha palët e përfshira kanë vullnet dhe angazhohen për realizimin e aktiviteteve të parapara me këtë dokument;
- Bizneset tregojnë gatishmëri për të punësuar pjesëtarë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 2 të paraparë me këtë dokument janë:

- Mungesa e angazhimit dhe përkushtimit të palëve të përfshira për të marrë përgjegjësi që dalin nga ky Plan;
- Mungesa e bashkëpunimit nga bizneset përfituese të subvencioneve
- Mungesa e bashkëpunimit nga vetë pjesëtarët e komuniteteve

3.3. Shëndetësia

Edhe përkundër shumë intervenimeve që janë bërë në përmirësimin e shëndetit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Rahovecit ka nevojë të intervenohet në disa aspekte.

Faktorët që ndikojnë në shëndetin e njeriut janë të ndryshëm e në shumë raste edhe të pa menaxhueshëm, megjithatë, aspekte si: Vaksinimi i fëmijëve dhe në përgjithësi niveli i ulët i vetëdijes për tu përkujdesur më shumë për shëndetin mund të përmirësohen.

Marrë parasysh rëndësinë që kanë intervenimet në këtë fushë, ky Plan parasheh ndërmarrjen e disa veprimeve që do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së shëndetit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

3.3.1. Sfidat kryesore

Nga analiza e gjendjes që është bërë në kuadër të kësaj fushe, janë identifikuar një numër i madh i sfidave me të cilat ballafaqohet ky sektor. Më poshtë do të paraqesim disa prej sfidave që janë konsideruar si prioritare për t'u adresuar brenda periudhës zbatuese të Planit:

- Niveli i ulët i vaksinimit të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

- Mungesa e informimit dhe edukimit shëndetësor rreth çështjeve jetike shëndetësore për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian
- Mungesa e mjeteve financiare për të përmbushur nevojat për trajnim shëndetësor

Objektiva strategjike 3

Për të siguruar adresim të mirëfilltë të sfidave të renditura më lartë në fushën e shëndetësisë është përcaktuar ky objektiv strategjik:

Objektivi 3: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore dhe cilësisë së jetës te pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

3.3.2. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan Veprimi për fushën e shëndetësisë parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- **Rezultati 3.1.** Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
- **Rezultati 3.2.** Sigurohet një mjedis i shëndetshëm për popullsinë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

3.3.3. Përshkrimi i aktiviteteve

REZULTATI 3.1:	Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 3.1.1 Organizimi i vizitave periodike shëndetësore në familjet e komuniteteve nga QKMF	Rritja e besueshmërisë së familjeve të komuniteteve, veçmas fëmijëve, në raport me institucionet shëndetësore dhe familjarizimi me to, do të ndikonte në ngritjen e vetëdijes së pjesëtarëve të komuniteteve për të shfrytëzuar këto shërbime. QKMF me përkrahjen e DShMS dhe ZKKK, organizon vizita periodike në familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Qëllimi i vizitave do të jetë ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë nevojtarët, dhe në të njëjtën kohë edhe informimi i familjeve për rëndësinë e përkujdesjes ndaj shëndetit.
Aktiviteti 3.1.2 Identifikimi i fëmijëve të pa imunizuar dhe imunizimi i tyre	ZKKK në bashkëpunim me DShMS bëjnë identifikimin e të gjithë fëmijëve që nuk iu kanë nënshtruar procesit të imunizimit. Pas identifikimit të tyre, përmes vizitave familjare, apo edhe përmes organizimit të vizitave kolektive në lokacione të caktuara, bëhet imunizimi i tyre.

	Ky aktivitet mund të organizohet në bashkëpunim me Qendrat e Komuniteteve (aty ku ekzistojnë), OJQ-të apo edhe me institucionet arsimore.
REZULTATI 3.2:	Sigurohet një mjedis i shëndetshëm për popullsinë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 3.2.1 Organizimi i ligjëratave rreth edukimit shëndetësor dhe planifikimit familjar	DShMS në bashkëpunim të ngushtë QKMF dhe QMF duhet të organizojnë ligjërata të strukturuar rreth edukimit shëndetësor për familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Vend të rëndësishëm gjatë këtyre ligjëratave duhet të zë edhe çështja e planifikimit familjar. Për të realizuar këto ligjërata, DShMS do të bashkëpunoj edhe me OJQ lokale që punojnë në këtë fushë, por edhe me udhëheqësit e lagjeve, përkatësisht përfaqësuesit e komunitetit..
Aktiviteti 3.2.2 Organizimi i fushatave vetëdijësuese për shërbimet që ofrojnë QMF	QKMF dhe QMF në bashkëpunim edhe me OShC-të, duhet të organizojnë fushata vetëdijësuese, ku target do të jenë familjet nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, me qëllim të informimit të tyre për shërbimet që ofrohen në QMF.
Aktiviteti 2.2.3 Organizimi i vizitave periodike për mamografi – ne koordinim me ZKKK	DShMS në bashkëpunim me ZKKK dhe MSh/QKUK organizojnë vizita periodike për mamografi. Kjo mund të realizohet duke i organizuar këto vizita në QKMF apo edhe duke i organizuar vizitat në komunitet përmes Mamografit Mobil që menaxhohet nga MSh.

3.3.4. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 3 të paraparë me këtë dokument janë:

- Të gjitha palët e përfshira kanë vullnet dhe angazhohen për realizimin e aktiviteteve të parapara me këtë plan;
- Gatishmëria e familjeve për të vazhduar ciklin e imunizimit të fëmijëve;

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 3 të paraparë me këtë dokument janë:

- Mungesa e angazhimit dhe përkushtimit të palëve të përfshira për të marrë përgjegjësitë që dalin nga ky plan;

- Mosgatishmëria e stafit të QKMF/QMF për të zhvilluar vizitat në terren

3.4. Banimi

Çështja e banimit për familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian vazhdon të jetë fokusi intervenimeve nga Komuna e Rahovecit.

Kthimi dhe ri-atdhesimi i familjeve nga komunitet rom, ashkali dhe egjiptian mund ta vështirësojë dhe thellojë problematikën e vendbanimeve. Migrimi i shumë familjeve në fillimin e vitit 2014, ku shumë familje kanë shitur shtëpitë e tyre për të kërkuar jetë më të mirë në vendet e perëndimit, e ka thelluar dukshëm mungesën e vendbanimeve, sidomos, pas kthimit të tyre.

Për të adresuar sa më mirë këtë çështje, komuna e Rahovecit duhet të ndër marrë masa dhe veprime konkrete. Të gjitha këto masa dhe veprime janë përmbledhur në objektiven e katërt të këtij Plani.

3.4.1. Sfidat kryesore

Nga analiza e gjendjes që është bërë në kuadër të kësaj fushe, janë identifikuar një numër i madh i sfidave me të cilat ballafaqohet ky sektor. Më poshtë do të paraqesim disa prej sfidave që janë konsideruar si prioritare për tu adresuar brenda periudhës zbatuese të Planit:

- Mos përmbushja e nevojave për banim për të gjitha familjet në nevojë
- Mungesa e mjeteve financiare për ndërtimin / renovimin e shtëpive për familjet në nevojë
- Mungesa e dokumentacionit nga pronarët

Objektiva strategjike 4

Për të siguruar adresim të mirëfillt të sfidave të renditura më lartë në fushën e banimit është përcaktuar ky objektiv strategjik:

Objektivi 4: Sigurimi i strehimit dhe banimit formal për familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

3.4.2. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan Veprimi për fushën e banimit parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- **Rezultati 4.1.** Avancim i ndjeshëm drejt zgjidhjes së problemit të banimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
- **Rezultati 4.2.** Ekziston Fondi Emergjent Komunal për nevojat e zgjidhjes së rasteve të banimit / bashkëfinancim të projekteve nga donatorët

3.4.3. Përshkrimi i aktiviteteve

REZULTATI 4.1:	Avancim i ndjeshëm drejt zgjidhjes së problemit të banimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 4.1.1 Hartimi i databazës së familjeve të pastrehë / familjeve në nevojë për banim	ZKKK në bashkëpunim me Komitetin për Komunitete dhe në koordinim me përfaqësuesit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian bënë identifikimin e të gjitha familjeve të pastrehë apo që kanë nevojë për banim.. Të dhënat e detajuara për secilën familje do të futen në një databazë e cila do të shfrytëzohet edhe nga institucione tjera komunale. Hartimi i kësaj databaze duhet të jetë një proces i vazhdueshëm për shkak të lëvizjeve të mëdha që ndodhin, më konkretisht, për shkak të ndërrimit të vendbanimeve nga familjet, ri-atdhesimin e familjeve, apo për shkak të paraqitjes së rasteve të reja për banim.
Aktiviteti 4.1.2 Zbatimi i kriterëve për përfituesit e mundshëm / për ndërtim apo renovim të shtëpisë	ZKKK në koordinim me donatorët dhe me përgjegjësit do të monitorojë zbatimin e kriterëve për përzgjedhjen e përfituesve të ndërtimit/renovimit të shtëpive për nevojtarët
REZULTATI 4.2:	Ekziston Fondi Emergjent Komunal për nevojat e zgjidhjes së rasteve të banimit / bashkëfinancim të projekteve nga donatorët
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 4.2.1 Organizimi i takimeve me kabinetin e kryetarit dhe asambleistët për të adresuar problemin e banimit për komunitetet në veçanti të rikthyerit – Rëndësia e themelimit të Fondit Emergjent	Përfaqësuesit e ZKKK zhvillojnë një plan të takimeve me Kabinetin e Kryetarit dhe me asambleistët për të adresuar problemin e banimit për komunitetet e në veçanti për rastet e rikthyer apo rastet që nuk e kanë të zgjidhur këtë problem. Takimet do të kenë karakter avokues, në mënyrë që të shtyhet përpara Themelimi i Fondit Emergjent për rastet e banimit ZKKK merr rol kryesor në hartimin e dokumentacionit për themelimin e Fondit Emergjent për rastet e banimit. ZKKK me përkrahjen e kabinetit të kryetarit caktojnë grupin

Aktiviteti 4.2.2 Hartimi i dokumentacionit përcjellës për themelimin e Fondit	punues për të hartuar dokumentacionin përcjellës për themelimin e këtij Fondi. Dokumenti kryesor që duhet të hartohet është: Akti i Themelimit - Statuti; ku do të përfshihen këto informata: - Mënyra e shfrytëzimit të Fondit - Rastet kur mund të shfrytëzohet Fondi - Kriteret për përfituesit nga ky Fond - Caktimi i mekanizmit në nivel komunal për menaxhimin e Fondit - Shfrytëzimi i Fondit për bashkëfinancimin e projekteve të donatorëve etj.
Aktiviteti 4.2.3 Takime periodike me donatorët potencial që do të kontribuonin në Fondin Emergjent për Banim	ZKKK në koordinim me Kryetarin e Komunës organizon konferencë të donatorëve një herë në vit me qëllim të informimit për ekzistimin e një Fondi të tillë dhe mundësisë së gjetjes së mënyrave të bashkëpunimit / bashkëfinancimit të projekteve të ndryshme që kanë për qëllim zgjidhjen e problemit të banimit për rastet në nevojë.

3.4.4. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 4 të paraparë me këtë dokument janë:

- Institucionet qendrore të Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë përkrahin Komunën e Rahovecit për ndërtimin / renovimin e shtëpive për familjet e pastreha të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në përputhje me masat dhe aktivitetet e parapara në “Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021”.

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 4 të paraparë me këtë dokument janë:

- Mos ndarja e buxhetit nga institucionet qendrore të Kosovës dhe nga donatorët, siç parashihet në “Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2023 – 2026”.

Objektiva strategjike 5

Për të siguruar adresim të mirëfilltë të sfidave të renditura më lartë në fushën e Diskriminimit është përcaktuar ky objektiv strategjik:

Objektivi 5: Luftimi i të gjitha llojeve të diskriminimit për pjestaret e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Objektiv 1: Informim dhe ndërgjegjësim i komuniteteve dhe publikut

Objektiv 2: Forcimi i ligjshmërisë dhe zbatimin e të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Objektiv 3: Integrimi social dhe ekonomik i komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Objektiv 4: Përmirësimi i arsimit dhe trajnimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Rezultatet e pritshme

1. Rritja e ndërgjegjësimit dhe dijes së të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shoqëri, duke ulur nivelin e diskriminimit dhe stereotipave negative ndaj tyre.
2. Rritja e numrit të rasteve të raportuara të diskriminimit ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, si rezultat i përmirësimit të mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të rasteve.
3. Zvogëlimi i nivelit të diskriminimit në institucionet publike dhe private, si rezultat i zbatimisë më të mirë të politikave dhe ligjeve të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
4. Përmirësimi i sistemit të drejtësisë dhe kapaciteteve të institucioneve për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të diskriminimit ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
5. Rritja e mundësive të punësimit dhe vetëpunësimit për pjestarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, duke kontribuar në integrimin social dhe ekonomik të tyre.
6. Përmirësimi i arsimit dhe trajnimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, duke rritur aksesin e tyre në arsim cilësor dhe duke përshtatur programet dhe materialet e mësimi në nevojat e tyre specifike.

Këto rezultate parashikohen të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes sociale, ekonomike dhe të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, duke i integruar ata në mënyrë të barabartë në shoqërinë ku jetojnë.

Përshkrimi i aktiviteteve

Rezultati 5.1	Luftimi i të gjitha llojeve të Diskriminimit
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 5.0	1. Zhvillimi i materialeve të informimit dhe ndërgjegjësimit në lidhje me të drejtat e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. 2. Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit nëpërmjet mediave të ndryshme, përfshirë media sociale, lajme, dhe programe televizive. 3. Organizimi i seminareve dhe trajnimeve për të rritur ndërgjegjësimin dhe dijen e të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian për profesionistët, punonjësit socialë, edukatorët dhe të tjerë aktorët e rëndësishëm të shoqërisë.
Aktiviteti 5.1	1. Përmirësimi i mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të rasteve të diskriminimit ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. 2. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të diskriminimit. 3. Zbatim i politikave dhe ligjeve të reja që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
REZULTATI 5.2:	Ekziston Fondi Emergjent Komunal për nevojat e zgjidhjes së rasteve të banimit / bashkëfinancim të projekteve nga donatorët
AKTIVITETI	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT
Aktiviteti 5.2	1. Zhvillimi i programeve të trajnimit dhe aftësimit për të rritur mundësitë e punësimit dhe vetëpunësimit për pjestarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. 2. Promovimi i bashkëpunimit midis komuniteteve dhe institucioneve lokale për zhvillimin e projekteve të përbashkëta ekonomike. 3. Sigurimi i aksesit të barabartë për shërbime sociale, arsim dhe shëndetësi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Aktiviteti 5.3

Aktivitete:

- 1. Përmirësimi i infrastrukturës arsimore në zonat ku jetojnë komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.**
- 2. Zhvillimi i materialeve të edukimit dhe trajnimit që i përshtaten nevojave specifike të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.**

1. Supozimi: Ndërgjegjësimi dhe informimi i komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian do të rrisë ndërgjegjësimin dhe angazhimin e tyre për të mbrojtur të drejtat e tyre. Rreziku: Niveli i ndërgjegjësimit mund të jetë i varfër ose të jetë pranuar me rezistencë nga anëtarët e komuniteteve, duke e bërë sfiduese përcjelljen e informacionit dhe përkrahjen e tyre.
2. Supozimi: Forcimi i ligjshmërisë dhe zbatimi i të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian do të ndikojë në zvogëlimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë. Rreziku: Mungesa e përkushtimit ose vështirësitë administrative në zbatimin e ligjeve dhe politikave të reja mund të krijojnë një dobësi në luftimin e diskriminimit dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve të përfshira.
3. Supozimi: Integrimi social dhe ekonomik i komuniteteve të përfshira do të ndihmojë në zvogëlimin e marginalizimit dhe në rritjen e mundësive për pjesëmarrje aktive në shoqëri. Rreziku: Mungesa e burimeve të mjaftueshme ose të dobëta në politikat e zhvillimit lokal dhe mbështetjen për iniciativat ekonomike mund të pengojnë arritjen e rezultateve të pritshme në integrimin social dhe ekonomik.
4. Supozimi: Përmirësimi i arsimit dhe trajnimit për komunitetet e përfshira do të rrisë aksesin e tyre në arsim cilësor dhe do t'i përgatisë ata për sfida të ardhshme. Rreziku: Mungesa e burimeve të mjaftueshme, infrastrukturës së dobët shkollore dhe sfidat në përkrahjen e programeve të adaptuara për nevojat specifike të komuniteteve të përfshira mund të ndikojnë në cilësinë dhe efektshmërinë e arsimit dhe trajnimit.

BUXHETI

“Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunëne Rahovecit 2023-2025” parashihet që për periudhën trevjeçare të zbatimit të ketë një buxhet total prej 81,620 EUR, prej të cilave 58,400 EUR parashihen të mbulohen nga Buxheti i Komunës, ndërsa 20,220 EUR parashihen të mbulohen nga donatorët e ndryshëm.

Në vijim është buxheti i detajuar për pesë vite i këtij plani të veprimit, i ndarë sipas fushave, sipas viteve dhe sipas burimeve të financimit (i shprehur në Euro).

Fusha	Burimi i financimit	Viti			Total EUR
		2023	2024	2025	
1. Arsimi	Buxheti i Komunës	500	12,110	7,110	20,720
	Donatorët	/	5,900	5,900	10,800
	Total	500	18,010	13,010	31,520
2. Punësimi dhe mirëqenia	Buxheti i Komunës	100	5,840	5,840	11,780
	Donatorët	500	3,660	3,660	7,820
	Total	600	9,500	9,500	19,600
3. Shëndetësia	Buxheti i Komunës	500	/	/	500
	Donatorët	/	/	/	/
	Total	500	/	/	500
4. Banimi	Buxheti i Komunës	/	13,000	11,400	24,400
	Donatorët	/	/	600	600
	Total		13,000	12,000	25,000
5. Luftimi i diskriminimit	Buxheti i Komunës	500	1000	1000	2500
	Donatorët	500	1000	1000	2500
	Total	1000	2000	2000	5000

Totali i buxhetit për të gjitha fushat : 81,620

Siç mund të shihet nga Planit të Zbatimit, ku paraqitet buxheti i detajuar për secilin aktivitetet të paraparë në kuadër të këtij plani të veprimit, i ndarë sipas fushave, sipas viteve dhe sipas burimeve të financimit (i shprehur në Euro), shumë aktivitete të këtij Planit nuk kanë kosto

financiare, për arsye se ato zbatohen nga institucionet lokale në kuadër të përgjegjësive të punës.

Po ashtu, në Plan nuk janë përfshirë aktivitete të cilat kanë filluar më herët dhe vazhdojnë të zbatohet nga komuna, OShC-të apo donatorët.

4. PLANI I

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN KOMUNËN E 2023-:

Fusha:

ARSIMI

Objekti i 1: Rritja e bashkëpunimit ndër-sektorial në funksion të përfshirjes dhe ofrimit të mundësive për zhvillim, aftësim dhe arsimim cilësor për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Përmirësohet qasja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim						BUXHETI (EURO)		
Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi / Aktiviteti	Perioda e implementimit	Përgjegjësi	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	Totali
1.1.1	Identifikimi i nevojave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushën e arsimimit, mirëqenies sociale, shëndetësisë dhe banimit. Hulumtimi zhvillohet dhe koordinohet nga ZKKK.	ZKKK në bashkëpunim me donatorët, zhvillojnë një hulumtim të nevojave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushën e arsimimit, mirëqenies sociale, shëndetësisë dhe banimit. Hulumtimi zhvillohet dhe koordinohet nga ZKKK.	2023-2025	ZKKK	Donatorët	Shpenzimet administrative (shitja e pyetjeve) dhe shpenzimet e terrenit (anketimi në secilën ekonomi familjare)	Buxheti i Komunitetit Donatorët	5,000
1.1.2	Identifikimi i fëmijëve në nevojë dhe sigurimi i mjeteve arsimore	ZKKK në bashkëpunim me DKA dhe QPS, bëjnë identifikimin e fëmijëve që kanë gjendje të rëndë ekonomike dhe që kanë fëmijë të moshës së arsimimit të detyruar. Fëmijët e identifikuar duhet të pajisen me pako shkollore së paku një herë në vit. Përveç përfshirjes me pako shkollore nga vet komuna, institucionet përgjegjëse mund të kërkojnë edhe ndihmën e donatorëve dhe të biznesve private për t'i përkrahur këta nënës me pako shkollore apo edhe me veshmbathje.	2023-2025	DKA, ZKKK	DSHMS, QPS, Donatorët	Për çdo vit shpërndahen 50 pako për fëmijët në nevojë 50 x 15 EUR = 750 EUR/vit	Buxheti i Komunitetit Donatorët	1,500
1.1.3	Organizohet mësimi intensiv për fëmijët që kanë vonesa në shkolimin e obliguar	DKA, ZKKK dhe shkollet në bashkëpunim MASHT dhe OIQ-të do të bëjnë identifikimin e të gjithë fëmijëve që kanë vonesa në shkolimin e obliguar. Duke u bazuar në gjendjen ekzistuese dhe në trendin e kthimit / r-ardhjesimit të fëmijëve nga vendet e ndryshme, supozohet që brenda 1 viti shkollor rreth 5 fëmijë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian do të përfshihen në mësimin intensiv. Mësimi intensiv do të aplikohet gjatë viteve të zbatimit të këtij plani të veprimit me qëllim të përfshirjes së të gjithë fëmijëve. Megjithatë, do të maksimizohen mundësitë që rastet që kanë mundësi, të përfshihen në sistemin e regjistrimit shkollor.	2023-2025	DKA, MASHT	OIQ-të, Donatorët	Supozohet që brenda një viti do të rreth 30 nënës. Kostoja vjetore për një nënë është 480 EUR (5 x 480 = 2,400)	Buxheti i Komunitetit Donatorët	4,800
1.1.4	Krijimi i ambienteve të sigura dhe atraktive në shkollë	DKA dhe shkollet në bashkëpunim edhe me OIQ-të dhe donatorët ndërmarrin aktivitetet për të përmirësuar sigurinë e fëmijëve në shkollë. Me theks të veçantë shkollet me përfshirjen e DKA-së zbatojnë politika dhe aktivitetet për parandalimin e dhunës në shkollë ku mund të përfshihen fëmijët nga grupet e cënueshme	2023-2025	DKA, MASHT	OIQ-të, Donatorët	S'ka kosto	/	/

1.1.5	Organizimi i trajnimeve kundër diskriminimit dhe paragjyqimeve / Organizimi i trajnimeve kundër braktisjes së shkolles	2023-2025	DKA, ZKKK	OIQ-të, Donatorët	2 trajnime në vit x 3 ditë për trajnim = 6 ditë trajnimi X 560 EUR/ditë trajnimi = 3360 EUR	Busheti komunal Donatorët	3.360	3.360	6.720
1.1.6	Identifikohen dhe adresohen rastet e braktisjes së shkollimit nga nënëgjat	2023-2025	DKA, Shkollat	OIQ-të dhe donatorët	S'ka kosto				
1.1.7	Monitorimi i suksesit dhe qëndrueshmëria e intervenimit	2023-2025	ZKKK, DKA	OIQ-të, Donatorët	S'ka kosto				
NEN-TOTAL 1.1									
							11.510	6.510	18.020

Rezultati 1.2 Ndergjegjeshen palet e interesit për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian											
Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Perioda e implementimit	Përgjegjësi	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kushtos	Burimi i financimit	2023	2024	2025	Totali
1.2.1	Organizimi i fushatave vetëdijëse për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për rëndësinë e shkolimit	ZKKK dhe DKA, në bashkëpunim me shkollat, si dhe me përfaqësues të OSHC-ve dhe donatoreve të ndryshëm organizojnë fushata vetëdijëse për familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Fushatat mund të bëhen në formë të kampajvave të ndryshme mediale, takime formale dhe jo-formale, organizimin e tryezave të diskutimit etj. Përveç fushatave informuese, këtu mund të përfshihen edhe studentë nga komunitet rom, ashkali dhe egjiptian apo edhe personatete të shteshtme të cilat do t'i tregonin stoniet e tyre të suksesit përmes vizitave nëpër familje, apo edhe përmes organizimit të sesioneve të ndryshme informative. Fushatat dhe sesionet informuese organizohen në prag të konkursve të shpallura nga shkollat dhe institucionet tjera arsimore.	2023-2025	ZKKK, DKA	Shkollat, OSHC-të, Donatorët	Shtypja e fletëpalosjeve, posterëve, tryeza diskutimi, vizita nëpër familje (kupsam 1000 EUR)	Buxheli komunal Donatorët		1,000	1,000	2,000
1.2.2	Organizimi i Kampeve verore	ZKKK, DKA, DKRS në bashkëpunim edhe me shkollat, si dhe me përfaqësues të OSHC-ve dhe donatoreve të ndryshëm organizojnë Kampe verore për fëmijët dhe prindërit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, me qëllim të motivimit të nënësve dhe prindërve për përfshirjen në arsim. Kampet organizohet njëherë në vit gjatë periudhës kur janë afatet për regjistrim në shkollë fillore dhe të mesme të lartë.	Maj - Gusht të çdo viti	OIQ-të, DKA, ZKKK	Shkollat, Donatorët	3 ditë x 50 pjesëmarrës = 150 x 20 EUR / ditë = 3000	Buxheli komunal Donatorët (50:50)		3,000	3,000	6,000
1.2.3	Organizimi i aktivitetëve të përshkëlësia prind-komunitet-shkolë	ZKKK, DKA, DKRS në bashkëpunim edhe me shkollat, si dhe me përfaqësues të OSHC-ve dhe donatoreve të ndryshëm organizojnë Aktivitete për fëmijët dhe prindërit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, me qëllim të motivimit të nënësve dhe prindërve për përfshirjen në arsim. Aktivitetet organizohen gjatë periudhës kur janë afatet për regjistrim në shkollë fillore dhe të mesme të lartë apo edhe duke shënuar Festat dhe Ditët e ndryshme Ndërkombëtare (p.sh. 1 Qershor - Dita e Fëmijëve; Dita Ndërkombëtare e leximit - 8 shtator; Muajt të Rinisë etj.)	2023-2025	DKA, ZKKK, DKRS, DIQ-të	Shkollat, Donatorët	4 aktivitete në vit x 500 EUR = 2000	Buxheli komunal Donatorët (50:50)		2,000	2,000	4,000
Mënyrë-Totall 1.2								6,000	6,000	6,000	12,000

Rezultati 1.3 Sigurohet qasje ne arsim për të gjithë fëmijët e komuniteteve rom, ashtu si dhe egjiptian të ri-adhesuar											
Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi / Aktiviteti	Perioda e implementimit	Përgjegësia	Institucion/organizata mbështetëse	Përshkrimi i koston	Burimi i financimit	2023	2024	2025	Totali
1.3.1	Identifikohen dhe adresohen rastet e fëmijëve të ri-adhesuar	ZKKK në bashkëpunim me sektorët tjerë në nivel komune, identifikon familjet e ri-adhesuara të cilat kanë fëmijë të moshës shkollore. Pas identifikimit, ZKKK ndërmerr të gjithë hapat për të adresuar në mënyrën më të mirë nevojat e këtyre familjeve. ZKKK krahas përkrashjes që ofron në kuadër të paktitave të ri-adhesimit, do të ofrojë edhe përkrashje shprehëse për familjet e moshës shkollore p.sh. përkrashje për t'u pajisur me dokumentacionin përkatës, përkrashje për të nostrifikuar dokumentet. Kjo përkrashje nënkupton mbulimin e shpenzimeve financiare për këto shërbime dhe për varjetje ardhje në MASHT/Pristinë. Supozohet që brenda një viti mund të ketë 10 raste të tilla.	2023-2025	ZKKK	DKA, OIQ-të dhe donatorët	10 nxënës x 50 EUR = 500 EUR në vit	Buxheti komunal	500	500	500	1,500
Mën-Torali 1.3								500	500	500	1,500
Totali Objektiv 1:								500	18,010	13,010	31,520

Fusha: PUNËSIMI DHE MIRËQENIA SOCIALE

Objekti 2: Përmirësimi i mirëqenies dhe standardit jetësor përmes sigurimit të punësimit të qëndrueshëm dhe shërbimeve sociale efikase

Rezultati 2.1 Përmirësimi i mirëqenies dhe standardit jetësor përmes sigurimit të punësimit të qëndrueshëm dhe shërbimeve sociale efikase										
Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi / Aktiviteti	Përkoha e implementimit	Përgjegjësi	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	BUXHETI (EURO)		
								2023	2024	2025
2.1.1	Fushatë informuese dhe avokuese për respektim të kësaj së punësimit për komunitetet	ZKKK në bashkëpunim me Zyren e Punësimit si dhe me përfaqësues të donatorëve të ndryshëm organizojnë fushatë avokuese në nivel komunal për të avancuar zbatimin e kësaj së punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo fushatë do të koordinohet nga ZKKK dhe ka për qëllim informimin e të gjitha institucioneve në nivel komune, bizneseve, punëdhënësve potencial, por edhe publikut në përgjithësi për kuotat e përcaktuara me ligj për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve.	2023-2025	ZKKK, Zyra e punësimit	OSHC-të, Donatorët	Shtypja e fletëpalosjeve, postereve; shpërndarja e tyre (kumpsum 500 EUR)	Buxheti i Komunës	500	/	500
2.1.2	Identifikimi i fuqisë punëtore nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (i të papunëve dhe punëdhënësve) dhe hartoni një databazë. Në bazë të nevojës hartoni plane përkatëse të bashkëpunimit ndërmjetësor në rast të ndryshimeve me qëllim të rrjesës së punësimit të përfaqësuesve të komuniteteve.	ZKKK në bashkëpunim me Zyren e Punësimit bënë identifikimin e fuqisë punëtore nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (i të papunëve dhe punëdhënësve) dhe hartoni një databazë. Në bazë të nevojës hartoni plane përkatëse të bashkëpunimit ndërmjetësor në rast të ndryshimeve me qëllim të rrjesës së punësimit të përfaqësuesve të komuniteteve.	2019-2021	ZKKK, Zyra e punësimit	OSHC-të, Donatorët	S'ka kosto	/	/	/	/
2.1.3	Ofrimi i kurseve shtesë për aftësim profesional dhe kurseve aranzonale për punëdhënës nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian	ZKKK në bashkëpunim me Zyren e Punësimit bënë identifikimin e të gjithë punëdhënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Në koordinim të ngushtë me Qendrat për Aftësim Profesional, duke u bazuar në nevojat e punëdhënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, hartoni plane për përshkrimin e kurseve për aftësim profesional. ZKKK dhe Zyra e Punësimit mund të gjejnë alternativë për organizimin e këtyre kurseve nga QAP-at e tjera. Kjo mund të bëhet duke organizuar transportin për të interesuarit, deri tek QAP-at nga qytetet tjera. Supozohet që brenda një viti, mund ti kemi 5 raste të tilla.	2020-2021	Komuna	OSHC-të, Donatorët	5 të interesuar x 66 ditë trajnimi x 10 EUR/ditë	Buxheti i Komunës, Donatorët	/	3,300	3,300
2.1.4	Përkrahje për të rinjtë nga komunitetet për të hapur biznese të reja	Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me donatorët potencial ofronjë mundësi aplikimi për të rinjtë nga komunitetet që kanë përfunduar shkollimin e lartë, me ide për start-up biznese. Praktikant e deritanishme kanë treguar që komuniteti i donatorëve është i interesuar për të përkrahur krijimin e bizneseve të reja. Komuna do të shfrytëzojë këto mundësi duke participuar me mjete vetanake në njërën të tilla.	2020-2021	Komuna	OSHC-të, Donatorët	2 ide për start-up biznes/vit x 3000 EUR (1 ide komuna + 1 ide donatorët)	Buxheti i Komunës, Donatorët	/	6,000	6,000
Mën-Totali 2.1								500	9,300	9,300
										19,100

Rezultati 2.2 Përmirësimet pjesëmarrja në skemat sociale e familjeve në nevojë nga komunitetet rom, ashtali dhe egjiptian										
Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Perioda e implementimit	Përgjegjësi	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	BUXHETI (EURO)		
								2023	2024	2025
2.2.1	Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të komuniteteve rom, ashtali dhe egjiptian në skemat sociale	Në Komunën e Rrahovecit ka pasur raste, kur familjet në nevojë për shkak të neglizhencës kanë humbur asistencën sociale, apo nuk janë fare përfshirë në skemat sociale. Kjo ka ardhur si pasojë e mos-informimit të familjeve me kushitet, procedurat dhe kushtet për të qenë përfshirë në skemat sociale. Për të shpërndarur situata të tilla, ZKKK, DSHMS dhe QPS në bashkëpunim me OSHC-të identifikojnë nevojat e të gjitha familjeve nga komuniteti rom, ashtali dhe egjiptian që kanë nevojë për tu përfshirë në skemat sociale. Sipas nevojave të identifikuar, DSHMS dhe QPS do të ndërmarë të gjithë hapat e nevojshëm për ti përfshirë në skemat sociale familjet në nevojë. Thëkësia vërejtje do të kufizohet familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara	2023-2025	ZKKK, DSHMS	QPS, OSHC-të, Donatorët	S'ka kosto	/	/	/	
2.2.2	Parandalimi i punëve të rënda dhe mbrojtja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashtali dhe egjiptian	Rastet e shumta të shfrytëzimit të fëmijëve qoftë për punë të rënda apo edhe shfrytëzimit të tyre për të kërkuar fëmoshë obligojnë institucionet lokale që të zbatojnë masa për parandalimin e kësaj praktikë të fëmijëve. ZKKK do të ketë rol monitorues dhe mobilizues për të ofruar institucionet dhe mekanizmat tjerë, në mënyrë që të parandalohet çdo keqpërdorim i fëmijëve të komuniteteve qoftë nga familja, apo grupet tjera të interesit.	2023-2025	ZKKK, DSHMS	OSHC-të, Donatorët	S'ka kosto	/	/	/	
2.2.3	Koordinimi i shuar në mes sektorëve komunal për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashtali dhe egjiptian në punësim dhe shërbime sociale	ZKKK do të themelojë një mekanizëm komunal ndërshtetor që do të ketë për mandat koordinimin e të gjithë alterëve për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashtali dhe egjiptian në punësim dhe shërbime sociale. Në këtë mekanizëm do të bëjnë pjesë: ZKKK (koordinatori), DSHMS, QPS, Zyra e punësimin, DKA, OIQ, të blinset etj. Varesisht nga nevojat, ky mekanizëm mund të zgjerohet edhe me përfaqësues nga palët me interes.	2023-2025	ZKKK	DSHMS, QPS, DKA, Zyra e Punësimin, OSHC-të, Donatorët	S'ka kosto	/	/	/	
2.2.4	Organizimi i takimeve periodike për koordinim në mes të sektorëve	ZKKK si koordinatore e Grupit koordinues do të organizojë takime periodike (2 herë në vit) për të siguruar që janë ndërmarë të gjithë hapat e nevojshëm për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashtali dhe egjiptian në punësim dhe shërbime sociale. Varesisht nga nevojat, ky Grup mund të takohet edhe më shpesh për të trajtuar çështjet dhe sfidat që paraqiten.	2023-2025	ZKKK	DSHMS, QPS, DKA, Zyra e Punësimin, OSHC-të, Donatorët	Shpenzimet për takimet e Grupit Koordinues (lumpsum 200 EUR/vit)	Buxheti i Komunitetit, Donatorë	100	200	200
Mënyrë 2.2								100	200	200
Totali i Objektivit 2:								600	9,500	9,500
										500
										19,600

Fusha: SHËNDETËSIA

Objekti 3: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore dhe cilësisë së jetës te pjesëtarët e komuniteteve rom, ashtakali dhe egjiptian

Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashtakali dhe egjiptian										
Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi / Aktiviteti	Perioda e implementimit	Përgjegësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	BUXHETI (EURO)		
								2023	2024	2025
3.1.1	Organizimi i vizitave periodike shëndetësore në familjet e komuniteteve nga QKMF	Rritja e besueshmërisë së familjeve të komuniteteve, veçmas familjeve, në raport me institucionet shëndetësore dhe familjaritë me to, do të ndihmonte në ngjirjen e vetdijes së pjesëtarëve të komuniteteve për të shfrytëzuar këto shërbime. QKMF me përkrahjen e DSHMS dhe ZKKK, organizon vizita periodike në familjet e komuniteteve rom, ashtakali dhe egjiptian. Qëllimi i vizitave do të jetë ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë nevojtarët, dhe në të njëjtën kohë edhe informimi i familjeve për rëndësinë e përkuqjes ndaj shëndetit.	2023-2025	QKMF / QMF	DSHMS, ZKKK	S'ka kosto	/	/	/	/
3.1.2	Identifikimi i familjeve të pa immunizuar dhe imunizimi i tyre	ZKKK në bashkëpunim me DSHMS bëjnë identifikimin e të gjithë familjeve që nuk lu kanë nënshtruar procesit të imunizimit. Pas identifikimit të tyre, përmes vizitave familjare, apo edhe përmes vizitave të vizitave lokale në lokacione të caktuara, bëhet imunizimi i tyre. Ky aktivitet mund të organizohet në bashkëpunim me Qendrat e Komuniteteve (aty ku ekzistojnë). OIQ-të apo edhe me institucionet arsimore.	2023-2025	ZKKK, DSHMS, QKMF / QMF	OIQ-të	S'ka kosto	/	/	/	/
				Nën-Totali 3.1						
Sigurimet nje mjedisi shëndetësor për popullsinë e komuniteteve rom, ashtakali dhe egjiptian										
Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi / Aktiviteti	Perioda e implementimit	Përgjegësia	Institucioni/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	BUXHETI (EURO)		
								2023	2024	2025
3.2.1	Organizimi i ligjeratave rreth edukimit shëndetësor dhe planifikimit familjar	DSHMS në bashkëpunim të ngushtë QKMF dhe QMF duhet të organizojnë ligjerata të strukturuar rreth edukimit shëndetësor për familjet e komuniteteve rom, ashtakali dhe egjiptian. Vend të rëndësishëm gjatë këtyre ligjeratave duhet të zë edhe çështja e planifikimit familjar. Për të realizuar këto ligjerata, DSHMS do të bashkëpunojë edhe me OIQ lokale që punojnë në këtë fushë, por edhe me udhëheqës të lagjeve, përfaqësuesit të komunitetit.	2023-2025	DSHMS, QKMF / QMF, ZKKK	OIQ-të dhe donatorët	S'ka kosto	/	/	/	/
3.2.2	Organizimi i fushatave vetëdijësuese për shërbimet që ofrojnë QMF	QKMF dhe QMF në bashkëpunim edhe me OSHC-të, duhet të organizojnë fushata vetëdijësuese, ku target do të jenë familjet nga komunitetet rom, ashtakali dhe egjiptian, me qëllim të informimit të tyre për shërbimet që ofrohen në QMF.	2023-2025	DSHMS, QKMF / QMF, ZKKK	OSHC-të, Donatorët	Shërbija e fletëpalosjeve, posterëve: tyeza diskutimi, vizita nëpër familje (të paktën 500 EUR)	Buxheti i Komunitetit, Donatorët	500	/	/
3.2.3	Organizimi i vizitave periodike për mamografi - ne koordinim me ZKKK	DSHMS në bashkëpunim me ZKKK dhe MSH/QKMF organizojnë vizita periodike për mamografi. Kjo mund të realizohet duke i organizuar këto vizita në QKMF apo edhe duke i organizuar vizitat në komunitet përmes Mamografi Mobili që menaxhohet nga MSH.	2023-2025	ZKKK, DSHMS	QKMF, MSH	S'ka kosto	/	/	/	/
				Nën-Totali 3.2						
Totali i Objektit 3:								500	500	500

Fusha: BANIMI

Objekti 4: Sigurimi i strehimit dhe banimit formal për familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Rezultati 4.1										
Avancimi i ndjeshëm drejt agjendës së problemat të banimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian										
Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi / Aktiviteti	Perioda e implementimit	Përgjegjësia	Institucion/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Burimi i financimit	BUXHETI (EURO)		
			2023-2025					2023	2024	2025
4.1.1	Haritimi i databazës së familjeve të pastrehë / familjeve në nevojë për banim	ZKKK në bashkëpunim me Komitetin për Komunitete dhe në koordinim me përfaqësuesit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian kanë identifikimin e të gjitha familjeve të pastrehë apo që kanë nevojë për banim. Të dhënat e detajuara për secilën familje do të futen në një databazë e cila do të shpërndahet edhe nga institucione tjera komunale. Haritimi i kësaj databaze duhet të jetë një proces i vazhdueshëm për shkak të lëvizjeve të mëdha që ndodhin, me konkretisht, për shkak të ndërrimit të vendbanimeve nga familjet, ri-adheshimin e familjeve, apo për shkak të paraqitjes së rasteve të reja për banim.	2023-2025	ZKKK	DSHMS, OIQ	S'ka kosto	/	/	/	/
4.1.2	Zbatimi i kriterëve për përfuturët e mundshëm / për ndërrim apo renovim të shtëpisë	ZKKK në koordinim me donatorët dhe me përgjegjësit do të monitorojë zbatimin e kriterëve për përzgjedhjen e përfuturve të ndërrimit/renovimit të shtëpisë për nevojtarët	2023-2025	Komuna	OSHC-të, Donatorët	S'ka kosto	/	/	/	/
				Nën-Totali 4.1						

Fusha: Anti-DISKRIMINIMIT

Objektivi 4: Sigurimi i strehimit dhe banimit formal për familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egiptian

Rezultati 4.1										
Avancimi i ndjeshëm drejt zgjidhjes së problemit të banimit për pjesetari të komuniteteve rom, ashkali dhe egiptian										
Kodi	Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Perioda e Implementimit	Përgjegësia	Institucion/organizata mbështetëse	Përshkrimi i kodit	Sursheni i financimit	BUXHETI (EURO)		
			2023-2025					2023	2024	2025
5.1.1	Informim dhe ndërgjegjësim i komuniteteve dhe publikut	• Zhvillimi i materialeve të informimit dhe ndërgjegjësimi në lidhje me të drejtat e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egiptian.								
		• Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimi dhe sensibilizimit nëpërmjet mediave të ndryshme, përfshirë media sociale, lajme, dhe programe televizive.		ZKKK	Komuna dhe OIQ	2500	Zkk & donator	500	1000	1000
		• Organizimi i seminareve dhe trajnimeve për të rritur ndërgjegjësimin dhe dijen e të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egiptian për profesionistët, punonjësit socialë, edukatorët dhe të tjerë aktorët e rëndësishëm të shoqërisë.								
5.1.2	Forcimi i ligjshmërisë dhe zbatimit të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egiptian	• Përmirësimi i mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të rasteve të diskriminimit ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egiptian.	2023-2025	Komuna	OSH-ët, Donatorët	2500	Zkk & donator	500	1000	1000
		• Forcimi i kapaciteteve të institucioneve për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të diskriminimit.								
		• Zbatim i politikave dhe ligjeve të reja që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egiptian.								
Nën-Totali 5.1										5000

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/23
Datë:00.8.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Për: Zyren Kombëtare të Auditimit



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunitetit)

Nr./Br./No 953 Nr. i faq./Br./str./No.pg 491

Data/Date 5.7.23

RAHOVEC / ORAHOVAC



Nga: z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunitetit të Rahovecit

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2022

Nr	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtar përgjegjës	Data e planifikuar zbatim të rekomandimit	Komente
1.	Çështja A1 - Parregullsi në procedurat e prokurimit publik	Në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë përcaktohen kriteret që duhet të plotësohen nga ofertuesit për të fituar kontratë publike. Me kushtet e veçanta të kontratës përcaktohet vlera (përqindja) dhe afati kohor i sigurisë së ekzekutimit të kontratës. Siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmes kontratës dhe është parakusht për nënshkrim dhe hyrje në fuqi të kontratës. Neni 36 i LMFPP përcakton që para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, OB i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në SIMFK. Gjithashtu, pika 70.10 e Rregullores 001/2022 për prokurimin publik, përcakton se pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i kontratës duhet të kyçet në sistem të prokurimit elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të kontratës. Si fazë e parë menaxheri i kontratës duhet të krijojë planin për menaxhimin e kontratës. Parregullsitë e hasura te procedura e prokurimit Ndërtimi i rrugës në Rahovec nga	Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve nga komisionet e vlerësimit bëhet në pajtim me kërkesat e përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Kontratat publike të mos nënshkruhen pa zotim paraprak të mjeteve në SIMFK dhe pa sigurim të ekzekutimit në afatin e përcaktuar. Planet e menaxhimi të përgatiten menjëherë pas nënshkrimit të kontratës	Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi sa më efektiv i Vlerësimit të tenderave me komisionet për vlerësimin e ofertave. Sigurimi i ekzekutimit do të zbatohet sipas dosjes së tenderit për vitin 2023	Zyra e prokurimit dhe drejtoritë përkatëse, menaxheret e kontratave	2023	

			rreth-rrotullimi deri në dalje të rrugës për Xërxë, në vlerë 1,222,222€, janë: - Në njoftimin për kontratë ishin kërkuar që kopjet e noterizuara të diplomave për stafin profesional, të prezantohen nga vet inxhinierët te noteri. Noterizimi i dokumenteve nuk ishte bërë nga vetë inxhinierët para noterit, por nga përfaqësuesi i kompanisë. Gjithashtu, noterizimi i diplomës për menaxherin e projektit, nuk ishte bërë nga dokumenti origjinal, por nga kopja e zakonshme, dhe noteri në shkresën e tij konfirmon se dokumenti origjinal nuk i është prezantuar. - OE që ka fituar këtë tender, ka ofruar për menaxherin e projektit referencë për përvojën e punës 4 vjeçare, por në CV-në e nënshkruar nga inxhinieri, nuk prezantohet se ka përvojë pune te kjo kompani. Në njoftim për kontratë ishte kërkuar që menaxheri të ketë së paku 7 vite përvojë pune, referencat e punës nga punëdhënësit, dhe CV të jetë e nënshkruar nga inxhinieri. - Çertifikatat ISO 9001-2015, ISO 14001-2015, dhe ISO 45001-2018, ishin kërkuar kopje nga origjinali, ndërsa janë ofruar të noterizuara nga kopja e zakonshme. Noteri në shkresat e tij, konfirmon se dokumenti origjinal nuk i është prezantuar. - Me njoftimin për kontratë është kërkuar që plani i menaxhimit të trafikut të jetë i nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit. Planin e menaxhimit që e ka ofruar kompania është vënë vetëm nënshkrimi, por je edhe emri dhe mbiemri për të përcaktuar se është nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit. Kontraktuesi nuk kishte dëshmi në ofertën e tij që ka inxhinier të komunikacionit. Parregullsitë e hasura te procedura e prokurimit Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit, në vlerë 272,350€, janë: - OE me çmimin më të lirë të ofertuar prej 243,020€, ishte eliminuar nga procesi i prokurimit me arsyen se kishte ofruar listën e panënshkruar dhe të pavulusur të projekteve të realizuara. Megjithatë, OE që është	Menaxherët e Kontratave	
--	--	--	---	-------------------------	--

[illegible]

		total pagesat përfshirë borxhin kryesor dhe kamatat ishin 304,560€. Nga kjo shumë, për paga e mëdijte ishin paguar 171,928€, për mallra e shërbime 15,188€, dhe për investime kapitale 117,442€.	mbikëqyrjen e realizimit të projekteve dhe në pagesën me kohë të obligimeve.			
3.	Çështja B1 - Urdhërblert et pas pranimit të faturës apo pranimit të furnizimeve dhe punëve	Neni 22 i Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF-Shpenzimi i parashë publikë, përcakton procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave. Nga kjo, kërkohet që zotimi dhe urdhërblertja ti paraprijë pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve. Në 8 pagesa për investime kapitale në vlerë totale 316,393€, dhe 11 pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 111,365€, zotimet dhe urdhërblertet ishin bërë pas pranimit të faturave apo pas pranimit të furnizimeve dhe punimeve. Vonesat në përgatitjen e urdhërblertjeve nga data e pranimit të faturave ishin nga 14 ditë deri 514 ditë. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në përgatitjen e urdhërblertjeve me kohë në SIMFK.	Kryetari duhet të sigurojë që procesit të blertjeve apo porosisë për punë, furnizime dhe shërbime dhe punë të kontraktuara ti paraprijë përgatitja e zotimit dhe aprovimi i urdhërblertjeve në SIMFK.	Konsiderojmë se ky rekomandim, nëse jo plotësisht, pjesërisht do të zbatohet gjatë këtij viti.	Drejtoria përkatëse dhe Zyra e Prokurimit.	2023
4.	Çështja B2 - Vonesa në pagesën e obligimeve financiare	LMFPP dhe Rregulla financiare Nr.01/2013/MF për shpenzimin e parave publike, përcakton se, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Nga auditimi i pagesave kemi identifikuar se obligimet ndaj kontraktuesve nuk ishin realizuar brenda afatit ligjor prej 30 ditëve nga data e pranimit të faturës. Kjo është hasur në 28 pagesa për investime kapitale në vlerë 1,143,154€, 16 pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 128,92€, dhe një pagesë në vlerë 1,864€ nga kategoria e subvencioneve. Vonesat ishin nga 2 javë deri 17 muaj. Kjo ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime pa zotim paraprak të mjeteve buxhetore.	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, dhe se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda afatit kohor ligjor.	Me zbatimin e rregullores financiare nr.01/2013, gjatë vitit 2023, vlerësojmë se ky rekomandim nëse jo plotësisht, pjesërisht do të zbatohet. Konsiderojmë se ky rekomandim, nëse jo plotësisht, pjesërisht do të zbatohet gjatë këtij viti.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Prokurimit.	2023

5.	Çështja B3 - Garancioni i punimeve jo në afatin e duhur	Ligji Nr.03/L-048 për MFPP, në nenin 39.1, parasheh që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Nga analiza e data bazës së furnitorëve, kemi vërejtur se gjatë vitit 2021 ishin kryer pagesa në shumën 2,523,472€ apo 1,165 raste të pagesave nga lista e furnitorëve, të cilët e kishin tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh deri në dy vite. Hyrja në obligime pa buxhet dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mos realizimin e pagesave brenda afatit kohor ligjor, që kanë rezultuar dhe mund të ndikoj njëherit në shtimin e numrit të realizimit të pagesave përmes vendimeve gjyqësore/ përmbarimore.	Kryetari duhet të forcojë kontrollin në procesin e menaxhimit të pagesave, për të siguruar që Komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme dhe që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor.			
6.	Çështja A3 - Ndarje jo e duhur e detyrave	Sipas nenit 38 të Rregullores MF-Nr. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, udhëheqësi përcakton ndarjen e detyrave që ndanë operacionet dhe përgjegjësitë për zbatimin e dy ose më shumë fazave të një procesi ose aktiviteti në mes të punëtorëve të ndryshëm. I njëjti punëtorë nuk mund të jetë përgjegjës njëkohësisht për miratim, zbatim, kontabilitet dhe kontroll. Në komisionin e vlerësimit të aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për klubet dhe shoqatat sportive dhe OJQ për vitin 2022, një anëtar i komisionit përbëhej nga zyrtari çertifikues. Kjo ka ndodhur për shkak mos veprimit në përputhje me kërkesat ligjore për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi.	Kryetari duhet të sigurojë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi në pajtim me kërkesat dhe procedurat e MFK-së, ashtu që i njëjti zyrtar të mos marr pjesë në dy apo më shumë faza të procesit.	Rekomandim i zbatuar	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe komisioni për vlerësimin e kërkesave (aplikacione ve).	2023
7.	Çështja B4 Vonesa në realizim të projekteve kapitale	Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik, pikat 61.6, 61.19 dhe 61.20 përcaktojnë se: Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se kontraktuesi kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Gjithashtu, me kushtet e veçanta të kontratës përcaktohet afati kohor i realizimit të projekteve. Vonesa në realizim të projekteve kapitale janë hasur te kontratat: • Ndërtimi i objektit të çerdhes së fëmijëve në fshatin	Kryetari duhet të sigurojë se projektet kapitale realizohen brenda planit dinamik të përcaktuar me kontratë, dhe për vonesat e pa arsyetuara të aplikohen penalet e parapara me kontratë.	Deri në fund të vitit fiskal, ky rekomandim pjesërisht do të zbatohet, e në vitet në vazhdim, plotësisht do të zbatohet.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa, zyra e prokurimit dhe drejtoritë përkatëse	2023

	Ratkoc, në vlerë 468,298€, e nënshkruar në muajin nëntor 2018, do të duhej të përfundonte brenda dy viteve. Projekti nuk ishte përfunduar deri në fillim të muajit dhjetor 2022.					
	- Ndërtimi i kanalizimeve ne komunën e Rahovecit, ne vlerë 441,156€ dhe aneks kontrata ne vlere 40,530€, duhej të përfundonte në fund të vitit 2020, ndërsa ka zgjatur deri në maj 2022. - Riparimi i monumenteve kulturore - historike, Lot 2, e nënshkruar me datë 20.09.2021, në vlerë 130,016€ ishte planifikuar të realizohet për 430 ditë. Deri në dhjetor 2022 ishin realizuar 36% e punimeve të kontraktuara. - Ndërtimi i tregut ditor në fshatin Ratkoc, në vlerë 69,997€ është nënshkruar e date 18.06.2021, me afat të realizimit prej 120 ditëve, ishte realizuar me 6 muajt vonesë. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në menaxhimin e kontratave publike dhe mungesës së mjeteve buxhetore.					
8.	Çështja C1 - Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve	Me planin kontabël definohet se shpenzimet duhet të regjistrohen në kategoritë adekuat ekonomike. Gjithashtu, Udhëzimi Administrativ Nr. 2005/08 për klasifikimin ekonomik të shpenzimeve përshkruan qartë definicionet e kategorive ekonomike që i përdor Thesari për të regjistruar dhe raportuar shpenzimet. Pagesa e faturës në vlerë 7,000€ për furnizim me material ndërtimor për 13 renovimin e shtëpive të komuniteteve jo-shumicë, ishte bërë nga kategoria e investimeve kapitale, ndonëse shpenzimi i takon kategorisë së subvencioneve. Kjo ka ndodhur për shkak të mos planifikimit të duhur të shpenzimit në kategorinë përkatëse ekonomike.	Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në kategoritë adekuat të buxhetit apo të ri-destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme, dhe që pagesa e shpenzimeve të realizohet nga buxheti i kategorisë adekuat ekonomike.	Do të zbatohet ky rekomandim sepse pagesat për kategori të shpenzimeve do të bëhen nga kodet adekuat (subvencione dhe transfere) dhe jo nga kategoria investime kapitale.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa,Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	Konsolidimi i deroj më se do të zbatohet deri në fund të vitit fiskal 2023
9.	Çështja A4 - Parregullsi	Sic shpjegohet me pikën 54.15 të Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, Kurdo që Autoriteti kontraktues (AK) nuk dine sasitë indikative, kontratat me çmime për	Kryetari duhet të sigurojë se te kontratat publike të kontraktuara permes	Konsiderojmë se ky rekomandim, nëse jo plotësisht,	Drejtoria përkatëse	2023

në menaxhimi n e kontratave publike të kontraktua ra përmes procedurës me çmim të poentuar (peshuar)	njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në baze të rëndësishë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavan i +/- 30%. Gjithashtu, në shpjegimin nr. 68, të KRPP-së, përcaktohet se AK duhet të luajnë një rol aktiv në përcaktimin sa më të saktë të vlerës së parashikuar e më këtë edhe vlerës së kontratës (të realizuar). Duke pasur parasysh faktin se peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, kjo nënkupton që edhe sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë, por të ruajnë të njëjtin raport. Funksioni i vetëm i peshimit të çmimit gjatë kontraktimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët. Gjatë realizimit të (3) tri kontratave publike me çmim të poentuar, nuk është ruajtur raporti ndërmjet sasisë apo përqindjes së realizuara të kategorisë, dhe peshës apo përqindjes së dhënë gjatë kontraktimit asaj kategorie. Rastet janë hasur të: • Kontrata publike Hartimi i projekteve të ndryshme, me vlerë totale të parashikuar 350,000€, janë përcaktuar 7 kategori ku secilës kategori i është përcaktuar pesha apo përqindja e shpenzimit. Për kategorinë I.G - Projektimi i urave, mbikalimeve, trotuareve, etj. e peshuar 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës ose 35,000€, vetëm për situacionin e parë të punimeve, për këtë kategori ishin shpenzuar 212,004€ apo 61% e vlerës së përgjithshme të kontratës, duke tejkaluar me 51% vlerën e parashikuar. Kjo kategori kishte çmimin më të lartë 3.08€ të peshuar në krahasim me kategoritë tjera (0.11€, 0.13€, 0.16€, 0.12€, 1.73€). Kontrata është fituar nga OE që ka ofruar çmimin e peshuar më të ulët, përderisa realizimi i 61% të kontratës është bërë për kategorinë me çmimin më të lartë. • Kontrata publike, Mbikëqyrja e investimeve kapitale, në vlerë totale të parashikuar 80,000€, ishte kontraktuar bazuar në çmimin për njësi dhe duke përcaktuar rëndësinë dhe peshën (%) e dhënë për secilën kategori/pozicion. Paramasa apo specifikacioni teknik ishte ndarë në pesë kategori kryesore, të peshuara me përqindje sipas shpenzimit. Për kategorinë E- projekte të objekteve	procedurës me çmim të peshuar, raporti i peshimit apo përqindjes së përcaktuar për kategoritë të jetë i njëjtë edhe gjatë realizimit përkatësisht pagesave.	pjesërisht do të zbatohet gjatë këtij viti.	dhe Zyra e Prokurimit.
---	--	--	--	-------------------------------

					ndërtimore të ndryshme, e peshuar 10% e vlerës së përgjithshme të kontratës ose 8,000€, i shin shpenzuar 62,085€ apo 78% e vlerës së përgjithshme të kontratës.
					Kontrata publike, Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve, në vlerë totale të parashikuar 150,000€, ishte kontraktuar bazuar në çmimin për njësi dhe duke përcaktuar rëndësinë dhe peshën (%) e dhënë për secilin kategori/pozicion. Paramasa apo specifikacioni teknik ishte ndarë në pesë kategori kryesore, të peshuara me përqindje sipas shpenzimit. Për kategorinë 1 - shenjetime horizontale të komunikacionit, e peshuar 22% e vlerës së përgjithshme të kontratës ose 33,000€, i shin shpenzuar 84,623€ apo 56% e vlerës së përgjithshme të kontratës. Gjithashtu, këto kontrata gabimisht i shin konsideruar kontrata publike kornizë, ku devijimi i lejuar është përcaktuar +/- 30%, ndonëse te kontratat publike me peshim nuk vlen pragu +/- 30% . Kjo kishte ndodhur për shkak të planifikimit të dobët të nevojave nga njësia kërkuese dhe mungesës së kontrolleve adekuate në menaxhimin e kontratave.



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më 31.7.2023 (e hënë), me fillim në orën 10:15. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, zt. Arbër Zenuni. Në fillim konstatoi se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, zt. Smajl Latifi, Nënkretar zt. Fatmir Iska, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit, kjo është seanca e shtatë (7) për këtë vit kalendarik.

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 18 korrik, për këtë seancë, ka përgatitur këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave Komunale në Vrajakë;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës në Vrajakë;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave komunale në Xërxë;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës në Xërxë;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të Strehimores “Shtëpia e Sigurt”;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimit dhe i plotësimit të vendimit 01 Nr.408/22, i datës 28.12.2022, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.263/22, i datës 25.1.2022 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshim-plotësimit të vendimit 01 Nr.265/22, i datës 25.1.2022, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
11. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit 01 Nr.326/22, i datës 31.5.2022, për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
12. Shqyrtimi i Raportit Financiar janar - qershor 2023;
13. Shqyrtimi i Raportit të ZKA-së, për vitin 2022;
14. Shqyrtimi i Raportit nga Drejtoria e Arsimit rreth përfundimit të vitit mësimor 2022/2023;
15. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
16. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
17. Shqyrtimi i Informatës mbi realizimin e Planit për Mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike në Komunën e Rahovecit;
18. Shqyrtimi i Informatës mbi realizimin e Planit të punës së Zyrës së Prokurimit, janar – qershor 2023;
19. Shqyrtimi i Raportit 6 muajor të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe.

Kryesuesi – Fillimisht hapësirën për një fjalë rasti e ka ish kryesuesi, zt. Defrim Kafexhiu.

Defrim Kafexhiu - Atëherë përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryesues Arbër Zenuni, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit. Faleminderit për mundësinë e fjalës, desha ta uroj kuvendin për përzgjedhjen e kryesuesit të ri të kuvendit dhe t'i uroj suksese në zhvillimin e punës së kuvendit komunal të Rahovecit. Meqenëse u konfirmua vendimi i shkarkimit dhe përzgjedhjes së kryesuesit të ri të kuvendit komunal, Arbrit i uroj shumë suksese në udhëheqjen e kuvendit dhe besoj që është nder sikurse që ka qenë edhe për mua. Personalisht ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin dhe gjithashtu ekzekutivin e komunës. Banorët e Komunës së Rahovecit i informoj që tani e tutje në cilësinë e anëtarit të kuvendit komunal do të rreshtohem nga radhët e opozitës dhe do t'i bashkohem atyre për opozitbërje, monitorim dhe dhënien e kritikave kundrejt ekzekutivit dhe kryetarit të komunës.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit i nderuar kryesues, ekzekutiv, kolegë, përfaqësues të mediave, qytetarë. Desha të flas në lidhje me atë që, nëse e ka trajtuar komisioni kërkesën e profesorit Shkodran Imeraj lidhur me përkrahjen financiare për përkthimin e librit në gjuhën angleze “Masakra e forcave serbe në Pastasel të Rahovecit, 31 mars 1999” Këtë kërkesë pala e ka paraqitur me datë 26.06.2023. E falënderoj profesorin për mbledhjen e këtyre argumenteve dhe fakteve të krimit kundër njerëzimit që ka kryer pushteti serb dhe njëkohësisht i inkurajoj autorët tjerë të shkruajnë për çdo masakër që ka ndodhur në rajonin e komunës sonë.

Kryetari – Faleminderit i nderuar kryesues, Arbër Zenuni, nënkryetar, anëtarë të kuvendit, drejtor, përfaqësues të mediave. Jemi të informuar për angazhimin e profesorit Shkodran Imeraj dhe jam në dijeni që e ka bërë një kërkesë për përkrahje financiare për përkthim në gjuhën angleze, mirëpo këtë vit nuk mendoj që kemi mundësi ta mbështesim financiarisht sepse libri është promovuar vonë (para disa ditësh), gjithashtu edhe unë kam qenë i ftuar aty. Vitin e ardhshëm do t'i shohim mundësitë tona për subvencionim.

Kryesuesi – Atëherë nëse edhe dikush nuk ka ndonjë gjë për të shtuar, rendin e ditës si të tillë e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash miratohet rendi i ditës për sot.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi – A ka dikush ndonjë vërejtje apo koment për procesverbalin e mbledhjes së kaluar, nëse jo e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash aprovohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, kryesues, kolegë asambleistë, drejtorë, media. Më lejoni ta uroj kryesuesin e sapo zgjedhur. Uroj që kryesuesi i ri të punojë për të gjithë dhe kushtimisht po them që Kurani e Bibla për të, të jetë Rregullorja, Statuti dhe Ligji për vetëqeverisje lokale.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues! Përshëndetje për juve, kryetarin e komunës, anëtarët e kuvendit, përfaqësuesit të LMT-së, OSBE-së, media. E kam një pyetje për drejtorin e Rinisë, Kulturës dhe Sportit: Janë ndarë pak mjete për rregullimin e sallës në Celinë dhe ku jemi me punime? Pyetja tjetër për drejtorin e Shërbimeve Publike dhe atë të Bujqësisë: Rugët fushore në Celinë janë në gjendje shumë të keqe dhe mund të konstatoj lirisht që asnjë rrugë nuk është e përfunduar gati që 20 vite. Është mirë që të paktën një rrugë të jetë e rregulluar mirë dhe më pas vazhdojmë sipas mundësive buxhetore që i kemi.

Edona Kryeyiu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Në emër timin personal i uroj shumë suksese kryesuesit. Dua të ndalem konkretisht për konkursin e vitit shkollor të klasëve të dhjeta 2023-2024. Duke i analizuar konkursin e shpallur nga DKA nga gjithsej 4 shkollat e mesme, në 3 prej tyre e kam bërë një analizë të vogël. Shkolla e Mesme e Lartë “Xhelal Hajda – Toni” – 6 paralele në shkenca natyrore dhe 2 në shkenca shoqërore. Shkolla e Mesme e Lartë “Ukshin Hoti” – 3 paralele në shkenca natyrore dhe 3 në shoqërore. Shkolla e Mesme e Lartë “12 Maji” – 3 paralele në shkenca natyrore dhe 3 të tjera në shoqërore. Pyetje për DKA-në është, pse edhe në shkollën “Xhelal Hajda” në Rahovec nuk praktikohet e njëjta politikë apo planifikim. Logjika e thotë shumë qartë: Në momentin kur një person me ndikim të madh e bën një kombinatori të tillë dhe kjo është duke ndodhur në vitet e fundit sa është Aleanca në pushtet. Për realizimin e këtij qëllimi, domosdoshmërisht drejtorive të shkollave iu imponohet që në shkenca natyrore të

pranojnë edhe nxënës me sukses të dobët apo thjeshtë pa kritere. Shqetësimi tjetër më shqetësues janë konkurset që po shpallen gati çdo muaj. DKA për ata mësimdhënës që janë pa plotësim norme, ose nuk i ka të dhënat e sakta, ose shpall konkurse për punësimin e militantave politik. Me keqardhje ju them që e keni demotivuar rininë e komunës sonë. Me e keqja është që kandidatët kanë mundësi të pranohen edhe pa diplomë adekuata. Për ta parandaluar një keqveprim të tillë, kërkoj nga kuvendarët që të marrin një vendim duke e formuar një komision të përbërë nga të gjitha partitë politike, me qëllim që verifikimit të dosjeve të të punësuarëve nëpër shkolla.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues! Desha të ndërlihem te drejtori i bujqësisë rreth rregullimit të këtyre rrugëve fushore. A ka ndonjë plan të veprimit për rregullim dhe sesi do të mirëmbahen, sepse në fshatin Hoçë e Vogël dhe Brestoc, këto rrugë janë në gjendje të mjerueshme. Për drejtorin e Shërbimeve Publike, para disa jave e kam bërë edhe një reagim publik për rregullimin e rrugës kryesore. Kompania që e ka tenderin e ndriçimit publik, prishjen e rrugës gjatë punimeve nuk e ka kthyer në gjendjen e mëparshme dhe qytetarët me vetiniciativë janë detyruar ta rregullojnë dëmin e shkaktuar nga operatori ekonomik. Poashtu nga vërshimet e fundit, rëra dhe balta që ka hyrë brenda në lagje të fshatit ende nuk është pastruar, gjithashtu kam kërkuar nga qytetarët që të mos marrin iniciativë për pastrimin e lagjes, sepse komuna është përgjegjëse për këto punë.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues! Urime për detyrën, shëndet dhe punë të mbarë. I nderuar kryetar i komunës, kolegë, ekzekutiv dhe të gjithë të pranishëm. Hapësira publike e ndërtuar e quajtur Shesh në qendër të qytetit pas situatës së krijuar, kam pranuar shumë telefonata për ta ngritur shqetësimin në asamble komunale dhe besoj që do të vie edhe një petition edhe prej qytetarëve sepse po e shohin si vështirësi funksionimin normal të komunikacionit në qendër të qytetit. Është fakt që diskutimi publik është mbajtur edhe me qytetarë edhe me biznese, mirëpo sot ata po e shohin si diçka që shfaqë vështirësi. Kërkoj nga ekzekutivi organizimin e një takimi të përbashkët me qytetarë, biznese dhe banorë që jetojnë afër, ta shohim saktësisht se çfarë shqetësimi kanë dhe ta bëjmë një zgjidhje duke iu përshtatur kërkesave të qytetarëve. E dya, në bazë informatave që i kam, komuna e Rahovecit është pa kontratë për mbikëqyrjen e projekteve. Para dy jave është vendimi i fundit i OSHP-së, e cila i ka anuluar procedurat tenderuese, duke i kërkuar ekzekutivit ta rishpallë tenderin për kompaninë mbikëqyrëse. Në këtë periudhë kohore 2023, janë filluar disa projekte si: Sheshi Qëndror, shkolla në Xërxë dhe Ratkoc dhe këtu e kam një pyetje: A ka organ mbikëqyrës -profesionist të përcaktuar nga komuna e Rahovecit që i përcjellin zhvillimet e punimeve (dhe mundësisht, a janë të brendshëm apo të jashtëm?). Drejtorat mund të jenë menaxherë të kontratave që e përcjellin dinamikën e punimeve, por nuk janë njerëz me kualifikim specifik për mbikëqyrje.

Bejtullah Deliu – Faleminderit i nderuar kryesues! Urime për detyrën e re, uroj që të kemi çasje sikurse me kryesuesin e mëhershëm. I nderuar kryetar, drejtorë, kolegë. Një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike: Është promovuar rregullimi apo asfaltimi i rrugës “Ali Sokoli”, mirëpo vështirësitë që ka rruga “Përmeti” konkretisht komplet lagjja për çasjen në rrugën “Ali Sokoli” është problematike ende dhe gropat që janë në trotuare pamundësojnë çasjen e lehtë në asfalt.

Sejfullah Sejfullahu – Faleminderit kryesues! Përsëritet për të gjithë. Kryesues, urime për postin, por menjëherë e keni një vërejtje, ujin e pijes që e kemi afër është i nxehtë. Po drejtohem te drejtori i Shërbimeve Publike: Punën “bërllog” e kemi andej ka fushat, kanalizimi ka dështuar dhe ka dalur mbi sipërfaqe. Kërkesa ime është se cilat janë mundësitë për intervenim këtu? ... Kërkesa tjetër është për kryetarit, rrethi në Krushë të Madhe duhet të riaktualizohet sepse pritja e gjatë për kyqje në rrugë është duke shkaktuar probleme në komunikacion. Me përgjegjësinë më të madhe ju them që vetëm dje kam pritur mbi 20minuta për t’u kyqur në rrugë.

Rumir Zhuniqi - Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit dhe qeveri komunale. Unë i kam dy pyetje drejtuar kryetarit dhe drejtorave përkatës! Pyetja e parë është rreth kubëzimit të rrugicave në komunën e Rahovecit, përkatësisht në 2021 është lidhur një kontratë dhe kur do të fillojë kubëzimi i rrugëve në fshatin Fortesë? Sepse në njërin prej “loteve” është i shkruar kubëzimi në Fortesë. Pyetja e dytë është rreth një shqetësimi që e kanë fermerët të cilët janë dëmtuar në vitin e kalur nga breshëri dhe vërshimet, gusht-shtator. Kompenzimi i dëmeve nga Ministria e

Bujqësisë ka ndodhur pjesërisht dhe shumica e fermerëve nuk kanë përfituar nga ky kompensim. Kanë bërë ankesë dhe është aprovuar, por kompensimi ende nuk ka ndodhur. E di që nuk është përgjegjësi komunale, mirëpo a ka komunikim drejtoria me ministrinë dhe kur pritet të bëhen kompensimet.

Dafina Gashi – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar i komunës, nënkryetar, asambleistë, drejtorë, media, të pranishëm. Meqenëse u diskutuan rrugët fushore edhe unë po ndërlihem me këtë çështje. Po e paraqes një kërkesë të vazhdueshme që ma kanë bërë qytetarët e fshatit Nagac. Është një rrugë e quajtur “Bertone” e cila ka nevojë për rregullim sepse në mungesë të kësaj rruge, 23 ha tokë mbesin të papunuara dhe janë afër 15 familje që nuk kanë çasje në mal. Rruga është e gjatë 800m. Pyetje për drejtorinë e Kulturës: Fillimi i investimit në këndin e lojërave, a pritet që punimet të përfundojnë këtë vit?...

Leonard Morina – Faleminderit kryesues! Përshëndetje për kryetarin, drejtorët dhe të gjithë të pranishmit. I kam dy pyetje për drejtorinë e Arsimit: Në pyetjen e parë, në një konkurs të datës 30.05.2023 për staf të qerdheve janë kërkuar 16 edukatore. Edukatorja është e kualifikuar për grupmoshat 3-6 vjeq. Ky konkurs ka qenë për qerdhet e reja apo për qerdhen në qytet dhe kush do t'i mësojë fëmijët nga 0-3 vjeq, sepse këtu kërkohet një kualifikim tjetër. Pyetja e dytë është për qerdhet e ndërtuara në shekullin XXI në vitin 2023, a do të ketë vende për fëmijët me nevoja të veçanta, sepse deri më tani në secilën qerdhe nuk ka çasje për fëmijë me nevoja të veçanta. “Alamet” inxhiniera, ndërsa qerdhet e shekullit XXI nuk kanë çasje për fëmijët me nevoja të veçanta.

Kryetari – Faleminderit kryesues, njëkohësisht urime për përgjegjësinë e re! Të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive. Do t'i jap përgjigje Burim Krasniqi rreth mbikëqyrjes. E vërteta është që ne kemi pasur mbikëqyrje të jashtme dhe zakonisht rrallë ka ndodhur që kemi qënë pa mbikëqyrje. Gjithmonë është mirë të kemi mbikëqyrje edhe pse nuk është që kemi ndonjë përvojë të mirë në këtë aspekt. E vërteta është që vendimi i OSHP-së e ka rikthyer në një pikë të caktuar procedurën e prokurimit pas një anekse, është rishpallur procedura e re dhe shpresojmë që brenda afatit optimal do të kemi një kontratë për mbikëqyrje të jashtme. Sipas një modeli të ofruar nga USAID-i, drejtori i drejtorisë përkatëse është mbikëqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës dhe për shkak të peshës së investimit në projektin e Sheshit Qëndror, kemi krijuar grup punues për mbikëqyrje. Te sheshi në qendër: Problemi qëndron se ende nuk ka përfunduar projekti dhe është shumë e rëndësishme që sapo të përfundohet dhe të shënjohet do të lehtësohet qarkullimi, sepse hapësira për qarkullim të automjeteve është zgjeruar, por nuk është e paraparë që aty të parkohen automjetet. Kjo është sfidë edhe për policinë e Kosovës. Në çoftëse në përfundimin e projektit do të kemi jofunksionalitet, ne jemi të hapur për zgjidhje tjera. Sa i përket rrugëve fushore, të dy operatorët që i kemi nuk kanë arritur ta zbatojnë detyrën që e kanë për zbatimin e kontratës dhe me jemi duke e analizuar situatën që në mundësinë e parë t'i shkëpusim kontratat. Te kompensimi i dëmeve në bujqësi dhe amvisëri, fatkeqësisht ka pasur kompensim selektiv dhe përfituesit nuk janë të gjithë ata që janë prekur nga dëmet. Kërkoj që Ministria e Bujqësisë ta kompenzojë pjesën e mbetur të bujqëve sepse të gjitha informatat janë në favor të të dëmtuarëve dhe çdo vonesë nuk është e mirë.

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, urime për detyrën e re! Përshëndetje për të gjithë. Sa i përket pyetjes së Lirigzon Kastratit, të çështja e larjes së rrugëve, kemi komunikuar me kompaninë e autorizuar dhe gjatë kësaj jave do ta bëjë larjen e rrugëve. Kampania e ndiçimit publik i ka rikthyer kubëzat në vendin e mëparshëm, mirëpo bëhet fjalë vetëm për një vijë të ngushtë që nuk është mbushur me elemente të betonit. Bejtullah Deliu, rreth rrugës “Ali Sokoli”, është e vertetë ajo që the, ne jemi duke punuar dhe duke i trajtuar pusetat, të cilat gjatë kësaj jave do të rregullohen si dhe do të përfundojnë punimet me shtresën e dytë të asfaltit. Te Sejfullah Sejfullahu për deponit ilegale! Sefë, sa i përket deponive nuk kemi kontratë, po i pastrojmë vullnetarisht dhe do ta vazhdojmë kujdesin në atë pjesë në Krushë të Madhe. Rumir Zhuniqi, pyeti për çështjen e kubëzimit në Fortesë! Në Fortesë ende nuk kemi filluar sepse ka një mori të rrugëve që duhet trajtuar, për momentin kompania është në pushim për shkak të sezonës verore dhe në momentin që të përfundohen trotualet në fshatin Nashpallë, me gjasë do të fillojnë punimet në Fortesë. Do të kyçem edhe një herë te Sefa sa i përket rrethrotullimit! Aty është problem teknik, është hekurudha që e ndalon rrethrotullimin dhe tutje ka prona private.

Sejfullah Sejfullahu – Faleminderit për përgjigje! Ne jemi të vetëdijshëm të gjithë që mbi hekurudhë njerëzit kanë ndërtuar ndërtesa 10 katëshe dhe duhet ta gjejmë një formë. Sa i përket pronave private duhet ta nisim një procedurë për një zgjidhje me shpronësim. Sa i përket kanalizimit duket të ripunohet prej filimit sepse numri i banorëve dhe shëpitë e banimit janë dyfishuar, prandaj duhet të bëhet një zgjidhje afatgjate.

Përparim Krasniqi – Sefë, unë jam i shkurtë dhe praktik. Është filluar procedura e tenderimit për kolektorin e ri në Krushë të Madhe dhe besoj që janë rreth 3km kolektor që do të bëhet me rritimin e ri të kanalizimit në atë zonë.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit drejtor për përgjigjet! Sa i përket asaj që the, që kompania i ka kthyer kubëzat në gjendjen e mëparshme, nuk është e vertetë dhe të jesh i sigurt që operatori nuk i ka kthyer kubëzat dhe as asfaltin ashtu siç kanë qenë. Sa i përket ndriçimit publik, e kam parë njoftimin në faqe të komunës dhe kur pritet realisht rikthimi i ndiçimit konkretisht në lagjen “Lezi”, “Krasniqi” e “Kastrati”. Poashtu, është një kanal i ujit në lagjen të varrezat, është një vijë që për shkak të të reshurave është mbyllur, duhet një investim i vogël që të hapet ajo vijë dhe uji të kalon në shtrat të lumit.

Përparim Krasniqi – Siç jeni informuar përmes faqes zyrtare të komunës, jemi duke punuar me ndriçimin e ri nga kompania “ESCO”, 7 vendbanime janë përruruar, kanë mbetur Celina dhe Zatriqi. Do të fillojmë në qytet me drita digjitale dhe me vendbanime të tjera që nuk ka ndiçim publik.

Avni Morina – Faleminderit kryesues! Urime për detyrën e re. Të nderuar anëtarë të kuvendit, kryetar, nënkryetar, përfaqësues të LMT-së, OSBE-së, media, drejtorë të drejtorive. Te pyetja e parë e bërë nga Edona Kryeziu në lidhje me konkurset e shpallura për shkollat e mesme të larta dhe për atë profesionale. Së pari, Edona e ka harruar institucionin e arsimit profesional që është poashtu i rëndësishëm sepse ka priofile të ndryshme aty. Dua të them që konkursi nuk hapet nga DKA-ja, por MASHT-i, pas analizave të marra prej shkollave. Shkollat janë të obliguara të formojnë komisione dhe në momentin e hapjes së konkursit të shpallur nga MASHT-i, janë disa kritere që shërbejnë për kualifikimin e nxënësve sipas profileve arsimore: Suksesi i nxënësve prej klasës 6-9, numri i pikëve në test në lëndët prioritare, suksesi në atë lëndë dhe numri i pikëve në testin e aritshmërisë. Sa i përket numrit të klasave, përcaktohet nga shkolla (me kërkesë në MASHT) duke u bazuar në numër të nxënësve. Kjo nuk do të thotë që sa klasa janë të parapara në shkenca natyrore dhe shoqërore, aq do të realizohen, sepse kjo varet nga interesimi i nxënësve. Shkollimi në fjalë (i mesëm i lartë) nuk është i obliguar dhe nuk kemi të drejtë t’iu imponojmë nxënësve klasën, shkollën apo vendin. Sa i përket dosjeve të punëtorëve në arsim, në mandatin e parë drejtorja jonë e ka pranuar një vërejtje nga ZKA për mosplotësimin e dosjeve. Tani, çdo punëtorë i arsimit një kopje të dosjes e ka në DKA, një në shkollë dhe një e mban për vete. Kontrollën e dosjeve kanë të drejtë ta bëjnë vetëm dy institucione: Inspektorati i Arsimit dhe Zyra Kombëtare e Auditimit. Nuk kam të drejtë as unë si DKA, e as zyrtarët e drejtorisë. Pyetja e dytë ishte nga Leonard Morina në lidhje me qerdhet. Është e vertetë që e kemi hapur konkursin për edukatore në qerdhet e komunës së Rahovecit, nuk kufizohet vetëm për tri qerdhe sepse ne kemi mungesë kuadri edhe në qerdhet “Tulipanët”, ngase aty është trefishuar numri i fëmijëve. Konkursi është quajtur “Për Edukatore” sepse edukatorja përfshin edhe edukimin e fëmijëve 0-3 vjeq, por edhe edukimin 3-5 vjeq. Uroj që sa më pak të ketë fëmijë me nevoja të veçanta në qerdhe, e kemi një numër simbolik në qerdhen e qytetit që edhe për këta do të kemi asistencë për fëmijë me nevoja të veçanta. Shqetësimi im kryesor është se kur do të vijë inventari për qerdhe, jemi në pritje të lidhjes së kontratës nga MASHT-it gati qe një vit e gjysmë. Pa inventarë, asnjëra prej qerdheve të reja të ndërtuara nga buxheti i komunës nuk mund të funksionalizohet.

Burim Krasniqi – Drejtor, pasi qerdhet nuk mund të funksionalizohen pa inventarë meqë nuk ka kontratë dhe nuk dihet se kur do të pajisen qerdhet! Pyetja është se a e keni planifikuar se çka do të bëhet me edukatoret që i keni pranuar në punë tani? Do të jenë në listë të pritjes, do të marrë pagë ose jo?

Avni Morina – Shpresojmë që deri në shtator (gjatë muajit gusht) të bëhet furnizimi i qerdheve me inventar sepse sipas zyrtarëve për infrastrukturë të MASHT-it kjo punë do të përfundojë në shtator. Po sikur të mos fillojmë në shtator, me

ligjin e ri për zyrtarë publikë të gjitha edukatorët që do të punësohen pas përfundimit të konkursit, kanë mundësi të punësohen përgjatë një viti, sipas mundësive të DKA-së.

Afrim Dina – Faleminderit kryesues! Të urrej për detyrën e re. I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë, të nderuar asambleistë. Përgjigjet më herët i dha kryetari, përveç sallës në Celinë, do të rregullohet edhe hapësira e jashtme me ilozim. Te pjesa e fushave sportive, me kontratën e re i kemi edhe shumë vendbanime tjera që do të përfshihen. Rreth pyetjes së asambleistes Dafina Gashi për parkun në Nagac! Është shumë e vertetë që ne kemi filluar punën aty, por për shkak të disa problemeve me operatorin, është dashur që punimet dhe procedurat të ndërpriten. Parku i parë që do të kryhet këtë vit në kuadër të DKRS-së do të jetë në Nagac, pastaj do të vazhdohet në vende të tjera.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave Komunale në Vrajakë;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë, anëtarë të kuvendit. Në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjit për dhënien e pronës me qera dhe statutit të komunës e kemi propozim-vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në periudh afatshkurtër deri në 15 vite në Vrajakë me nr. të parcelës 00171-0, në sipërfaqe prej 3500m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 4789 m².

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! Atëherë para se të kalojmë në votim, e drejta për komente është e anëtarëve të kuvendit!

Burim Krasniqi – Drejtor, në propozim thuhet për afat të shkurtër 1-15 vjet, por nuk ceket saktë periudha! Duket t'i jepni orientim edhe afatit kohor.

Afrim Oruqi – Paragrafi në pikën 3 është i përgjithshëm! E theksova që kërkohet miratim prej kuvendit për 15 vjet.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! Atëherë pas sqarimeve, këtë pikë e vendosim në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash kjo pikë miratohet.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës në Vrajakë;

Afrim Oruqi – Të nderuar anëtarë të kuvendit, sipas ligjeve të aplikueshme bëhet fjalë për të njëjtën parcelë, duket të formojmë një komision për përzbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim. Komisioni do të përbëhet prej 5 anëtarëve. Dy nga ekzekutivi, dy nga kuvendi dhe një nga shoqëria civile.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! Atëherë ftoj shëfat e grupeve që t'i bëjnë propozimet e tyre.

Hasan Përboqi – Në emër të grupit të asambleistave të Aleancës, propozojmë Afrim Berishën.

Leonard Morina – LVV, nuk kemi propozim!

Burim Krasniqi – LDK, propozojmë Faton Ramadanin!

Sejfullah Sejfullahu – PDK, nuk kemi propozim!

Kryesuesi – Atëherë përbërja e komisionit është me këtë renditje: Afrim Berisha (AAK), Faton Ramadani (LDK). Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht votohet komisioni.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave komunale në Xërxë;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit, para jush kemi materialin për dhënien në shfrytëzim të dy parcelave që janë pronë e komunës. Parcelat konkretisht janë te depot e Matreksit dhe jepen në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 vite, P-01036-0 (2445 m²) që në shfrytëzim jepen vetëm prej 1600 m² dhe P-01033-2 (2162 m²) dhe në shfrytëzim do të jepet 1900 m².

Burim Krasniqi – Drejtor, disa komisione janë bërë për disa parcela te matreksi. A kanë qenë ndonjëherë këto dy parcela në procedura të dhënies në shfrytëzim?...

Erhan Morina – Këto dy parcela kanë qenë në shfrytëzim deri më tani, tani i përfundon kontrata dhe janë për herë të parë në procedura.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! Nëse nuk keni edhe ndonjë koment apo diskutim, ftoj anëtarët e kuvendit për votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash edhe kjo pikë miratohet.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës në Xërxë;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues! Bëhet fjalë për të njëjtat parcela në Xërxë, duket të formojmë një komision për për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim. Komisioni do të përbëhet prej 5 anëtarëve. Dy nga ekzekutivi, dy nga kuvendi dhe një nga shoqëria civile.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! Shkojmë me propozimet nga shefat e grupeve të partive politike!

Hasan Përboqi – AAK, nuk kemi propozim!

Leonard Morina – LVV, nuk kemi propozim!

Burim Krasniqi – LDK, propozojmë Lirigzon Kastratin!

Melinda Iska – PDK, propozojmë Sejfullah Sejfullahun!

Kryesuesi – Atëherë përbërja e komisionit është me këtë renditje: Lirigzon Kastrati (LDK), Sejfullah Sejfullahu (PDK).

Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht votohet komisioni dhe kalon pika e gjashtë.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara;

Kryetari – Faleminderit! Në mungesë të drejtoreshës Sarandë, po e prezantoj. Përveç komiteteve obligative të cilat janë të parapara me statut dhe ligj, janë të parapara edhe themelimi i komiteteve konsultative që i shërbejnë qytetarëve të komunës sonë. Bëhet fjalë për një komitet të ri konsultativ për persona me aftësi të kufizuara dhe duhet të merret vendimi për komisionin që do ta bëjë shpalljen publike për themelimin e komitetit në fjalë, me përbërje 3 anëtarë nga kuvendi i komunës dhe dy nga ekzekutivi.

Burim Krasniqi – Këtu është ngatërruar pak, duhet me qenë dy vendime, një vendim që asambleja e themelon komitetin dhe një vendim që asambleja e themelon komisionin përzgjedhës. Sot nuk e zgjedhim komitetin, por komisionin i cili do ta zgjedhë komitetin konsultativ. Me shumë përgjegjësi konsideroj që këtu duhet të jeni dy vendime.

Isak Hoti – Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë, kryetar. E kemi para vetes një vendim për formimin e komisionit. Ne duhet të hapim konkurs përmes këtij vendimi, pas aplikimit ky komision aplikuesit do t’i vendosë në test, fituesit vijnë për propozim në kuvend dhe këtu bëhet vendimi për themelimin e komitetit.

Burim Krasniqi – Këtu thotë: Vendim për themelimin e komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, titulli i vendimit është ndryshe dhe brendësia ndryshe! Ne mund t’i nxjerrim dy forma të vendimeve: Një vendim me të cilin asambleja e aprovon themelimin e komitetit dhe një vendim për themelimin e komisionit. Ose titulli i vendimit është gabim, ose procedurat.

Isak Hoti – Atëherë mund të jetë edhe gabim teknik titulli, por pika 3 e vendimit i qartëson gjërat. Nuk guxojmë ta nxjerrim një vendim për themelimin e komitetit pa e bërë përzgjedhjen e këtyre pesë anëtarëve.

Burim Krasniqi – Mos më keqkupto! Po të them që titulli i vendimit është gabim, duket të përmirësohet, e votojmë edhe shkojmë tutje, shumë e thjeshtë.

Kryesuesi – Faleminderit zyrtarit ligjor! Atëherë ftoj shefat e grupeve për propozim të anëtarëve për komision.

Hasan Përboqi – AAK, e propozojmë asambleistin, Sinan Kryeziu!

Leonard Morina – LVV, e propozojmë Vlora Vuçitërna Çmega!

Burim Krasniqi – LDK, nuk kemi propozim!

Sejfullah Sejfullahu – PDK, propozojmë Melinda Oruqi Iska!

Kryesuesi – Atëherë përbërja e komisionit është me këta emra: Sinan Kryeziu (AAK), Vlora Vuçitërna (LVV) dhe Melinda Oruqi (PDK). Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash kalon përbërja e këtij komisioni.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit për mbulimin e pjesës së shpenzimeve të Strehimores “Shtëpia e Sigurt”;

Kryetari – Në këtë rast vazhdojmë me respektimin e memorandumit me “Shtëpinë e Sigurt” në Gjakovë. Fjala është për 2500€ që duhet të marrim vendim në kuvend që t’ia japim atyre çdo vit (për tri vite).

Burim Krasniqi – Kryetar, a mund ta kemi si informacion se çka shërben “Shtëpia e Sigurt”?

Kryetari – Informacione të detajizuara është e vështirë të japim sepse nuk është vendi i duhur, por në “Shtëpinë e Sigurt” trajtohen qytetarët që kanë probleme në familje, dhunë në familje dhe probleme të tjera.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar! Atëherë e vendosim në votim këtë pikë, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht kalon pika e tetë. Vazhdojmë me një pauzë një orëshe...

Kryesuesi – Përshëndetje edhe një herë, vazhdojmë me pikën e nëntë.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimit dhe i plotësimit të vendimit 01 Nr.408/22, i datës 28.12.2022, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.263/22, i datës 25.1.2022 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;

Kryetari – Duke mos humbur kohë, tani jemi në një situatë ku duhet ta bëjmë plotësim-ndryshimin e vendimit për anëtarët e KPF-së, sepse kemi kryesues të ri. KPF-ja ka një formulë të përfaqësimit që rregullohet me ligj. Besoj që grupi politik më i madh duhet ta bëjë një reflektim dhe grupet tjera t’i bëjnë propozimet.

Burim Krasniqi – Mendoj që duke e pasur parasysh formulën, ne si LDK nuk kemi çka të diskutojmë sepse gjërat dihen, grupet tjera le të shkojnë tutje.

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues! Ne si grup më i madh parlamentar në asamble, si çdo herë kemi treguar konstruktivitet edhe kësaj here kemi vendosur të kontribuojmë në atë drejtim që mos të bllokohet situata më tej në plotësim-ndryshimin e vendimit për KPF. Me vetëdëshirë asambleisti, Rumir Zhuniqi ka vendosur të tërhiqet, për arsye që Aleanca çdo herë është deklaruar që 50% të jenë femra, 50% meshkuj, por kësaj radhe kemi vendosur që femrave me iu dhënë hapësirë më të madhe. Shqipe Kryeziu dhe Bjondina Kleqka vazhdojnë në KPF, kryesuesi shkon me automatizëm.

Defrim Kafexhiu – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë, drejtorë. E falënderoj Hasanin për zemërgjerësinë, po ai nuk po na jep asgjë! Nëse e ka mirëkuptimin e anëtarëve të vet, mund të na jepni edhe një anëtarë ekstra, d.m.th të largohet edhe një anëtar prej KPF-së, përndryshe tre anëtarë janë të paraparë me ligj. Nuk ka mirëkuptim këtu e as zemërgjerësi, në bazë të përqindjes së votave që i ka, tre anëtarë i ka Aleanca, përqindja tjetër i takon LVV-së dhe dy partive tjera.

Hasan Përboqi – Ish kryesues, faleminderit për udhëheqjen që e keni bërë më herët në Kuvend dhe KPF, besoj që si Aleanca të kemi vlerësuar më mirë sesa grupet tjera. Për ta kërkuar edhe një anëtar shtesë në KPF, me zemërgjerësinë që e kemi ndoshta edhe do t’ju jepnim edhe një, por çfarë të bëjmë kur vullneti i qytetarëve ka qenë i tillë që ne ta kemi përfaqësuar në KPF kështu.

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues! Me leje, a më lejohet të flas një minutë jashtë rendit të ditës?

Kryesuesi – I nderuar, nuk lejohet!

Bejtullah Deliu – Faleminderit i nderuar kryesues! Në këtë pikë që duhet të bëhen këto ndryshime, vullnetarisht tërhiqem nga KPF-ja për t’i lënë hapësirë subjekteve në renditje të duhur.

Kryesuesi – Faleminderit zt. Deliu! Atëherë pas diskutimeve, vazhdojmë me propozime nga të gjitha grupet.

Ilir Pallqa – Thirrja për propozim duhet të niset nga grupi më i madh, e nise prej LVV-së e po ia bën “hyzmetin” për të ardhmen.

Hasan Përboqi – Nuk ka nevojë për propozim të reja sepse është plotësim-ndryshim, Shqipja edhe Bjondina mbeten, Rumiri tërhiqet, kryesuesi shkon me automatizëm.

Merisa Sharku Vuçiterna – Faleminderit, përshëndetje për të gjithë! Prej LVV-së, propozojmë dy emra: Leonard Morina, Defrim Kafexhiu.

Kryesuesi – Faleminderit! Atëherë nga propozimet e dhëna nga grupet e partive në kuvend, me këtë përbërje të komitetit e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht kalon kjo pikë me këta anëtarë: Arbër Zenuni, Shqipe Kryeziu, Bjondina Kleqka (AAK), Leonard Morina, Defrim Kafexhiu (LVV), Melinda Oruqi Iska (PDK), Burim Krasniqi (LDK).

10. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshim-plotësimit të vendimit 01 Nr.265/22, i datës 25.1.2022, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB);

Kryetari – Edhe këtu poashtu ka një ndryshim-plotësim, për shkak se Fadil Sylka ka qenë anëtar i KKSBB-së si përfaqësues i bizneseve, tani është ndërruar përfaqësuesi, Mustafë Korenica është tani dhe duhet të ndodh ky ndryshim.

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues! Me leje edhe një herë, a më lejohet të flas një minutë jashtë rendit të ditës?

Kryesuesi – I nderuar përgjigja e parë ishte që nuk lejohet, të kërkoj ndjesë. Faleminderit për mirëkuptim! Atëherë meqë nuk ka diskutime tjera lidhur me këtë pikë, e vendosim në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës.

11. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit 01 Nr.326/22, i datës 31.5.2022, për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;

Nënkryetari – Përhëndetje kryesues, urime pozitive e re. Gjithashtu edhe këtu kemi të bëjmë me një plotësim-ndryshim në përbërje të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale. Edmond Kabashi vullnetarisht është tërhequr dhe ne e kemi një propozim për ndryshim si eksperte të jashtme, Zana Çmega. Kërkojmë nga ju ta miratoni këtë vendim.

Lirigzon Kastrati – Meqenëse jam anëtar i këtij komiteti, dua ta falënderoj Edmondin, i cili ka qenë kontributdhënës i çmuar gjatë punës së komitetit. Uroj që edhe anëtarja e re të jetë me njohuri të fushës përkatëse.

Kryesuesi – Faleminderit! Nëse edhe dikush tjetër nuk ka diçka për të thënë rreth kësaj pike, e vendosim në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash kalon edhe kjo pikë.

12. Shqyrtimi i Raportit Financiar janar - qershor 2023;

Afrim Limani - Përhëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, anëtarë të kuvendit. Raporti 6 mujor financiar kësaj radhe është më voluminoz. Përveç pjesës kryesore të inkasimit të të hyrave dhe pjesës së shpenzimit të buxhetit, në këtë raport janë të inkuorporuar edhe pjesa e obligimeve kontraktuale dhe raporti mbi kontratat e lidhura nga Zyra e Prokurimit. Këtë-informata nuk e kemi obligim t'i fusim në këtë raport, por për hirë të transparencës kemi menduar që këto të dhëna të jenë pjesë e raportit. Të hyrat për 6 mujorin e parë për vitin 2023 në total janë 1.029.916€ dhe nëse bëjmë një krahasim me të njëjtën kohë me vitin e kalur, kemi një rezultat pozitiv prej 431.392€, gjala është për të hyrat e rregullta. Shpenzimi i buxhetit në total është 53.56%. Në pozicionin e pagave 56.24%, mallra dhe shërbime 53.15, komunal 51.18%, subvencione 57.46% dhe shpenzime kapitale 49.72%. Në fund i kemi të paraqitura edhe obligimet financiare që në total janë prej 388.883€.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues! E falënderoj drejtorin për prezantimin e Raportit Financiar për 6 mujorin e parë të këtij viti. Drejtor, ndoshta janë disa lëshime teknike dhe është mirë t'i përmirësoni sepse është një dokument i rëndësishëm. Te tabela 1.6, krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2022-2023 te kodi i tatimit në pronë 40/110, thotë: Planifikimi është 423.250€, e kur të dalim në anën tjetër te planifikimi dhe realizimi i tatimit në pronë dhe kur shkojmë përsëri te planifikimi për vitin 2023, shkruan: 295.257€, d.m.th nuk përputhen shifrat. Te shpenzimet, sipas kategorive ekonomike te paraqitja grafike buxhetin e keni shpenzuar mirë për këtë gjashtë mujor. Më poshtë, në faqe 12, te mallrat dhe shërbimet sipas kodeve ekonomike, i kemi disa shënime këtu që krahasohen me vitin 2022 dhe 2023. Te disa kode kemi një ndryshim goxha të madh, psh. Kodi 13/420, shërbimet e avokaturës në vitin 2022 i kemi 15.000, ndërsa në 2023 i kemi 31.000€. Kodi tjetër 13/480, shpenzimet për anëtarësim në vitin 2022 janë hargjuar 8000€, ndërsa në 2023 janë hargjuar mbi 30.000... kështu me radhë. Do të dëshiroja sqarime se pse kanë ndodhur këto ndryshime kaq të mëdha!

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues! Fillimisht te të hyrat nuk kam vërejtje te tabelat. Sipas të hyrave të realizuara në 2023 janë 671.526€, megjithatë e kemi një vendim të qeverisë së Kosovës për faljen e tatimit në pronë

deri në 100€! A do të ndikojë kjo në të hyrat e tatimit në pronë dhe a ka procedurë se çka do të ndodh me ata që e kanë paguar tatimin në pronë? Do të ketë kthim të mjeteve, apo zbritje të tatimit në pronë në vitin e ardhshëm? Te çështja e obligimeve kontraktuale (tab.3.7), tri kontratat e para janë obligime financiare, jo kontraktuale. Tjetër, të gjitha kontratat që janë të lidhuara prej janar-qershor 2020, sot janë obligime financiare me vlerë 1.4 milion. Duke e përfshirë komplet sipas raportit, nënkupton që Komuna e Rahovecit, sot, i ka 17.061.145€, obligime kontraktuale dhe financiare. Në qoftëse kontratat iu përmbahen afateve tre vjeqare (afatit kohor), a rrezikon kjo në mundësinë e lidhjes së kontratave të reja ndërkohë në mes komunës dhe operatorëve të tjerë?

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues! E falënderoj drejtorin për paraqitje të hollësishme të raportit financiar. Poashtu, e falënderoj për paraqitjen në detaje të pjesës së obligimeve financiare dhe kontraktuale që i ka komuna jonë. Kjo është një risi, përkundër asaj që nuk është obligim ligjor. Të hyrat janë rekord të shënuara për këtë 6 muaj dhe njëkohësisht duhet t'i falënderojmë qytetarët e Komunës së Rahovecit që janë tatimpagues të rregullt. Te pjesa e realizimit apo shpenzimit të buxhetit, janë rreth 53% e buxhetit është shpenzuar dhe duke e llogaritur me muaj, shpenzimi i buxhetit po shkon në mënyrë të duhur dhe njëkohësisht kjo gjendje tregon një performancë të mirë në realizimin e projekteve kapitale të parapara në buxhet për vitin 2023.

Leonard Morina – Faleminderit kryesues! Për dallim nga shefi i grupit të AAK-së, unë i ka parë shpenzimet jo në mënyrë të duhur! Psh. te veturat, Komuna e Rahovecit ka shpenzuar 77.973€ për 6 muaj në vetura të komunës. Kjo i bie që për secilin muaj ka shpenzuar 12.995€, këtu bëhet fjalë për sigurim, mirëmbajtje dhe karburante. Ndërsa vetëm për karburante ka shpenzuar 37.000€ brenda kësaj periudhe. Në një komunë kaq të vogël dhe të varfër e të shpenzoni në derivate mbi 37.000€, më duket që është shumë. Te kodi 133, udhëtimet zyrtare brenda vendit: Për gjashtëmujorshin e parë keni shpenzuar 28.000€ ose 4700€ në muaj. Nëse ka mundësi një sqarim se për të cilat udhëtime zyrtare bëhet fjalë? Te kodi 13420, përfaqësimi i avokaturës: Për gjashtë muaj keni paguar mbi 31.000€ shpenzime të avokaturës ose mbi 5000€ në muaj, kësaj ia shtojmë mbi 9000€ që i keni paguar për vendimet e gjykatës dhe i bie diku 40.000€ brenda 6 mujorshit. Te kodi 14310, dreka zyrtare: Për 6 muaj keni shpenzuar 3515€ ose mbi 500€ në muaj. Appetit i madh në paranë publike. Kryetar, qeverisja e mirë shkon duke e rritur cilësinë dhe duke i ulur shpenzimet, ju keni vepruar në të kundërtën. Në vitin 2022 në 6 mujorshin e parë keni shpenzuar 763.000€, ndërsa për 6 mujorshin e parë të vitit 2023 i keni shpenzuar 1.171.000€ ose 408.000€ më shumë sesa në vitin 2022. Pse ka ndodh kjo diferencë?

Bejtullah Deliu – Faleminderit i nderuar kryesues! Drejtori i Financave njihet dhe lavdërohet për saktësi, por te tabela 1.2, te planifikimi në 2023 është 722.801€, ndërsa realizimi është 1.290.916€ që d.m.th për 317.115€ është jashtë normës.

Afrim Limani – Fillimisht po i përgjigjem Burimit! Te pyetja për tatimin në pronë, te falja e 100€ që do të ndodh vitin e ardhshëm dhe ata të cilët kanë paguar hyjnë në parapagim. Sipas analizave që i kemi bërë ne, i kemi rreth 65% tatimpagues që janë të ngarkur prej 100€ te poshtë dhe përafërsisht ne do të dëmtohem 500.000€. Te obligimet kontraktuale, e thash edhe në fillim nuk e kam obligim t'i paraqes, por e bëj për shkak të transparencës. Në raportin që e keni ju para vetes, obligimet kontraktuale fillojnë që nga viti 2019 deri në 2022. Obligimet e vitit 2019 i kemi përfunduar me ekzekutimin e bartjes së mjeteve, gjithashtu i kemi përfunduar edhe disa të tjera të vitit 2020. Atëherë, vlera e obligimeve kontraktuale nga viti 2018 deri në fund të vitit 2022 është 27.198.000€, prej këtyre janë paguar 10.436.000€ dhe kanë ngelur papaguar edhe 16.762.000€ dhe realisht ne e shëndrrojmë në oblimi financiar, sepse obligim financiar llogaritet në momentin e pranimit të faturës. Nga 16 milionshi, nëse i zbresim mallrat dhe shërbimet (2.463.000€), mbesin edhe 14.298.000€ obligime kontraktuale dhe financiare. Në vitin 2023, vlera e parashikur e kontratave deri në muajin e gjashtë është 11.841.000€. Kontrata të lidhura i kemi 2.182.000€. Te Rasim Fazliu, mësues, është e vërtetë që e the atë, por, planifikimi i tatimit në pronë prej një faqe në tjetrën ndryshon, sepse në faqen e dytë është totali për gjashtë mujorin e parë, ndërsa te faqja e parë është në total për gjithë vitin fiskal. Hasan, faleminderit shumë për ato fjalë. Leonardi i bëri disa pyetje, psh. shpenzimi i karburantit: Duhet ta dini një gjë që vetëm QKMF-ja mbi 50% i hargjon karburante dhe mjete për sevisim, sepse janë pesë autoambulanca që vazhdimisht janë në qarkullim.

Mos ta ndërlikojmë shpenzimin vetëm të objekti i komunës. Te Bejta, planifikimi në total është prej 1.445.000€, mirëpo ne e kemi ndarë dhe për gjashtë muaj e kemi marrë një mesatare.

Rasim Fazliu – Drejtor, unë të mirëkuptoj ty që the, aty planifikimi është bërë për gjithë vitin, e këtu vetëm për gjashtë muaj. Mirëpo, kur e heqim shumën në tabelën 2.1 prej tabelës tjetër, ndryshimi del vetëm 27.000. A i bie kjo që për gjashtë muaj tjerë, tatimi në pronë do të vë vetëm 27.000? Faqe 5, te tabela 1.6, në fillim është: Tatimi në pronë i planifikuar në vitin 2023 është 423.250€. Te tabela 2.1 (faqe 6), thotë: Te planifikuara për vitin 2023 janë 395.250€.

Afrim Limani – Në faqe 5, te planifikimi i tatimit në pronë i kemi dy shtylla: Tatimi në pronë dhe tatimi në tokë dhe të dyja bashkë bëjnë 768.000, kurse ne i kemi të ndara dhe të përpjesëtuara në bazë gjashtë mujore.

Kryetari – Faleminderit kryesues! Besoj që drejtori i Financave dha sqarime të hollësishme. Ligji mbi tatimin në pronë është miratuar në kuvendin e Kosovës edhe në lexim të dytë. Në këtë ligj nuk është përfillur as Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe as komunat individuale. Falja prej 100€ me justifikime që i ndihmojnë qytetarët është legjitime, por me këtë gjë dëmtohet shumë interesi i qytetarëve në komunat e Republikës së Kosovës, sepse nga viti 2024 parashihet të kemi më pak të hyra nga tatimi në pronë. Është situatë paradoksale dhe padrejtësi në interesin publik, shkelje dhe cenim i autonomisë. Qeveria duhet t'ia kompenzojë komunave vlerën që ia fal qytetarëve, sepse komunat mbesin keq. Duhet të mos dekretohet ky ligj, ose duhet të shkojë në Gjykatë Kushtetuese dhe të kthehen në parlament për përfillje të interesit të komunave dhe asambleve komunale sepse ka shumë paqartësi. Çështja e anëtarësisë: Mos të harrojmë që ne jemi anëtar të asociacionit të komunave të Republikës së Kosovës. Kemi një projekt të përbashkët me Agjencinë e Zhvillomore Rajonale dhe kemi një anëtarësim të ri me Unionin e Bashkive Shqiptare në Rajon, (anëtarësia kushton 20.000€ në vit). Te Leonardi, rreth udhëtimet zyrtare brenda vendit: Kodet nuk i krijojmë ne, i krijon Ministria e Financave. Pra, nuk bëhet fjalë për udhëtimet e zyrtarëve të komunës, por për transportin e nxënësve, se udhëtimet e zyrtarëve të komunës brenda vendit nuk paguhet hiç. Unë kam pasur udhëtime zyrtare jashtë vendit, por nuk i kam marrë buxhet komunës. Drejtorët nuk kanë pasur udhëtime zyrtare. Apetit për ushqim kemi, darkat e drekat janë të parapara me ligj. Apetit ka edhe Kuvendi i Komunës dhe me mirëkuptim në mes drejtorit të Financave dhe ish kryesuesit, Defrimit, ju i keni dy darka, që gjithashtu kanë një kosto. E kemi edhe iftarin për kohën e Ramazanit dhe disa pozicione në kulturë. Një pyetje tjetër logjike që nuk e bëri askush këtu! Pse ka shumë sivjet inkasomë të tatimit në pronë? Ju e dini që qeveria e Kosovës bëri një "hallakamë" të madhe, njerëzit nga frika që po i bie të paguajnë edhe një herë më shumë, vraponin për pagesa të tatimit në pronë. Kjo është një indikator që qeveria ndonjëherë është mirë të bëjë këso eskivazhe, por edhe më mirë është që mos ta bëjë një ligj të tatimit në pronë pa u konsultuar me komunat. Mendoj që Raporti Financiar është në pajtim të plotë me rregullat e shpenzimit të buxhetit, gjithashtu të realizimi i buxhetit jemi shumë mirë me 53% në gjashtëmujorin e parë, ndërsa deri në fund të vitit besoj që të jemi deri në 97%.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues! Drejtor, po ndalem në dy çështje shumë shkurtë. E para, në bazë të analizës tënde që e the, i bie që 2023 të përfundojë me rreth 15 milion € obligime! Bazuar në KAB, për 2024 janë 8.5 milion investime kapitale dhe mallra dhe shërbime, në çoftëse i marrim këto obligime për dy vite, kjo nënkupton që për dy vitet e ardhshme vetëm 2 milion € keni të drejtë të lidhni kontrata, në çoftëse nuk "zhagiten" projektet. Tjetra, te tabela 3.6 (faqe 15), te çështja e planifikimit dhe realizimit të kontratave: Në çoftëse i mbledhim planifikimet e kontratave të Zyra e Prokurimit, shumat që i keni aty nuk bëjnë 11 milion në fund, është gabim. Planifikimi sipas raportit tënd është 11.86 milion, kontratat janë 2.2 milion. Planifikimi sipas raportit nga Zyra e Prokurimit është 1.65 milion, (200.000 më pak), kontratat është 4.357 (4 milion e 375 mijë €). Raporti i Zyrës së Prokurimit del më shumë sesa Raporti i Drejtorisë së Financave rreth 2.1 milion €. Në fund, për korrektësi, raporti i ka 19 faqe dhe jo 17.

13. Shqyrtimi i Raportit të ZKA-së, për vitin 2022;

Kryetari – Është lajm i mirë që Komuna e Rahovecit ka opinion të pamodifikuar për pasqyrat financiare për vitin 2022. Është lajm i mirë që ne kemi shënuar progras në zbatimin e rekomandimeve që kanë qenë në 2021, poashtu është shumë mirë që kemi zvogëlim të numrit të rekomandimeve për 2022 dhe realisht mund të themi që ky është një nga raportet më të mira në historinë e auditimit nga ana e ZKA-së. Rekomandimet e fundit kanë qenë rreth disa kontratave që janë

nënshkruar pa zotimin e mjeteve ose zotimi i mjeteve është bërë më vonë. Këto shqetësime menjëherë i kemi agresuar përmes themelimit të grupit punues për zbatimin e planit për adresimin e rekomandimeve. Për dallim prej vitit të kaluar, pasi që të gjitha kriteret janë të plotësuar, kësaj radhe Komuna e Rahovecit mund të jetë përfituese e Grantit të Performancës (mbi 2 milion €). Kanë qenë 14 rekomandime, tani janë 9 dhe opinioni është pozitiv për komunën tonë. I falënderoj të gjithë për këtë gjë.

Detrim Kafexhiu – Përsëritet edhe një herë për të gjithë! Më heret harrova që t'i përsëndes monitoruesit nga organizatat dhe mediat. Një kritikë për Leonardin, që më herët i përmendi drekat zyrtare, "a nuk pate ndonjë të keqe tjetër për ekzekutivin, po veç te drekat zyrtare". Te çështja e rendit të ditës, saktësisht te Raporti i ZKA-së për Komunën e Rahovecit, kryetari i përmendi të mirat dhe kualifikimin e duhur që e ka marrë komuna dhe mund të themi lirisht që është për t'u përsëndetur. Dua të ndalem te pika 2.1 (faqe 8), çështja A1, parregullsitë te procedurat e prokurimit: Prokurimi në një institucion në këtë rast në Komunën e Rahovecit, është një derë e "hambarit" të të mirave të përgjithshme të taksave të qytetarëve dhe rrjedhimisht prej aty lidhen kontratat, blihen mallrat dhe shërbimet tjera me paratë publike. Janë disa shkelje të lehta, psh: Te një operator ekonomik që e ka fituar një tender, ka ofruar për menaxherin e projektit, referencë për përvojën e punës 4 vjeçare edhe pse me kontratë është kërkuar që menaxheri t'i ketë së paku 7 vite përvojë pune. Forma e prezantimit të dokumenteve psh: Certifikatat ndërkombëtare, është kërkuar që t'i prezantohen autoritetit komunal që të jenë origjinale, por ato kanë qenë kopje të zakonshme. Një shkelje tjetër është që, në njoftimin për kontratë është kërkuar Plani i Menaxhimit të Trafikut të jetë i nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit, përderisa kontraktuesi nuk kishte dëshmi që në ofertën e tij kishte inxhinier të komunikacionit. ZKA këto shkelje i cilëson si parregullsi edhe pse unë besoj që këtu ka hapësira dyshuese për keqpërdorime gjatë proceseve të prokurimit. Psh: Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit me vlerë 272.000€, operatori ekonomik me çmimin më të lirë të ofertuar 243.000€, ishte eliminuar nga procesi me arsyen që e kishte ofruar listën "kinse" të panënshkruar dhe të pavulosur të projekteve të realizuara. D.m.th me ligj të prokurimit, oferta më e lirë duhet të merret për bazë, por ja që komisioni për vlerësimin e ofertave e ka eliminuar ofertën më të lirë. Operatori i eliminuar kishte ngarkuar në sistemin E-prokurimi listën e nënshkruar dhe të vulosur të projekteve të realizuara. Kjo besoj që është një shkelje më e madhe dhe lindi dyshimet për keqpërdorime në këtë proces të prokurimit. Poashtu edhe fituesi i këtij tenderi e ka ofruar sigurimin e ekzekutimit të kontratës me afat të vlerfshmërisë dy muaj më pak sesa është kërkuar me kushte të veçanta të kontratës. Nëse për një arsye është hedhur poshtë ofertuesi më i lirë, kjo është një arsye që të eliminohet edhe fituesi i tenderit. Një pikë tjetër që nuk është përgatitur Plani për Menaxhimin e Kontratës, këtu besoj që përgjegjësia bie mbi kryetarin e komunës apo te përcaktimi i menaxherëve të kontratës. Psh: Në rregullimin e shtratit të rekës Rahovec – Fortesë, menaxher i kontratës është Berat Duraku (ekonomist – drejtor i Bujqësisë) dhe rrjedhimisht mendohet që mund të jetë një mbikëqyrje jo e duhur në procesin e implementimit të projektit. Ndikimi prej këtyre gjetjeve (parregullsive) që i ka gjetur ZKA-ja, thotë që kjo ka ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes dhe kontroleve të pamjaftueshme në procedurat e prokurimit, në procesin e vlerësimit të tenderëve dhe në pakujdesinë e menaxherëve të kontratave. Të gjitha këto, përgjegjësinë e kanë te kryetari i komunës, përderisa me vendim të tij formohet edhe komisioni për procesin e vlerësimit të tenderëve dhe përzgjedhjen e menaxherëve të kontratave. ZKA-ja ia ka qëlluar 100% sepse po e shohin në implementimin e projekteve kemi zhagjitje të proceseve, projekte jo të kryera me kohë të përcaktuar me kontratë dhe kemi bllokim të rrugëve që njëkohësisht shkaktojnë probleme në komunikacion, që gjithashtu është e padrejtë në krahasim me funksionimin dhe jetën e qytetarëve të Komunës së Rahovecit. Për t'i shuar këtu dyshime që i kemi për keqpërdorime, i bëj thirrje kryetarit të komunës që t'i jep arsyetimet e duhura.

Kryetari – Faleminderit! Mirë është që e keni mundësinë tani ta lexoni Raportin e Auditimit dhe ta pasqyroni si të lexuar. Raporti është zyrtar dhe është publik në web-faqen e ZKA-së dhe të Komunës së Rahovecit. Për dyshimet që u përpoqe t'i shpërfaqësh këtu e që ta dëgjojnë qytetarët e Komunës së Rahovecit kudo që ndodhen, raporti për çdo dyshim shkon në prokurori dhe prokuroria është kompetente t'i spastrojë situatat të cilat mund të prodhojnë paqartësi. Fakti që ne jemi pajtuar me ato të gjetura, nuk e kemi mohuar faktin që ka dobësi në disa çështje për të cilat janë

përgjegjësitë e ndara. Zyra e Prokurimit konsiderohet si zyrë e kryetarit dhe kryetari i komunës është e vertetë që formon komisione për vlerësim, por nëse komisionin nuk e kanë vlerësuar drejt, ata përgjigjen dhe jo kryetari i komunës. Sipas ligjit të prokurimit, oferta më e lirë është bashkë me operatorin e përgjegjshëm, në çoftëse një operator nuk i posedon të gjitha dokumentet të futura në sistem online dhe pse është më i lirë, kjo nuk d.m.th që ai duhet ta fitojë tenderin. Sa i përket çështjes së vonesave të zbatimit të kontratës, kjo nuk ka të bëjë fare me atë që e tha parafolësi. Ekzistojnë disa faktorë pse mund të vonohen kontratat, mund të mos ketë buxhet, rritja e çmimeve – ndalon operimin. Çështja e mungesës së një inxhinieri të komunikacionit, a e dini që asnjë kompani që i ka paraqitur ofertat e veta nuk ka pasur inxhinier të komunikacionit, vetëm që në procedurë ka mbetur i tillë. Kuptohet që nuk ka reaguar askush, lenda ka kaluar, është lidhur kontrata dhe Auditori e ka gjetur. Të gjitha këto dilema hiqen, në momentin kur Njësia për Hetimin e Krimeve Ekonomike vlerëson që duhet ta ftojë në intervistë dikë. Kësaj radhe të gjeturat kryesisht janë të natyrës teknike, të cilat natyrisht hapin dilemë për sqarim, prandaj e kemi një plan dhe një grup punues për të shënuar progres në zbatimin e këtyre rekomandimeve. Psh: Nëse e dimë që nuk ka inxhinier me 7 vjet përvojë pune, duhet të vendoset përvoja e punës “deri” në shtatë vjet, d.m.th janë çështje që rregullohen me kritere që i vendosë Zyra e Prokurimit në pajtim me udhëzimet e marra nga KRPP. Pra, përvoja e punës, operatori më i lirë dhe më i përgjegjshëm, pamjaftueshmëria në mbikëqyrje, vonesa e kontratave, lëshimi i urdhërblërjeve pasi është pranuar malli, të gjitha këto janë duke u adresuar sepse janë rekomandime të reja. Lufta jonë e përbashkët është t’i zbatojmë këto dhe mund të na dalin të reja përsëri për vitin 2023, sepse një opinion i ZKA-së pa rekomandime nuk ka dhe nuk ekziston në glob. E përshëndes Afrim Limanin dhe kuvendin e komunës për presionin e bërë në adresë të përmirësimit të dukshëm dhe sot e kemi një raport shumë pozitiv.

Defrim Kafexhiu – Faleminderit kryesues! Nuk do ta kërkoja replikën, por gjithashtu nuk mund ta pranoj që dikush të më hedh “hi syve”. Sa i përket fushatës, zgjedhjet janë largë, kur të vie koha e tyre do të bëjmë edhe fushatë, nuk e kemi atë problem! Te parregullsitë e lehta të përmendura, ta zëmë, inxhinierin e komunikacionit pasi që nuk e kanë kompanitë, është shumë në rregull dhe kuptohet! Te çështja e përzgjedhjes së ofertuesit më të lirë, përderisa e ka dokumentacionin e kompletuar sepse këtu thotë që, operatori ekonomik që është eliminuar kishte ngarkuar ofertën elektronike në sistemin e-Prokurimit, listën e nënshkruar dhe të vulosur të projekteve të realizuara, teksa komisioni e ka hedhur poshtë për shkak të mungesës së vulës dhe nënshkrimit! Te vlerësimi se unë a e kuptoj, lexoj dhe a mund ta komentoj raportin e ZKA-së, nuk e vlerësoni ju, por qytetarët e Komunës së Rahovecit. Unë vetëm po e transmetoj atë që po e thotë Auditori. Poashtu edhe unë qytetarët i respektoj njejtë, qytetarët janë të Republikës së Kosovës, banorët janë të Komunës së Rahovecit dhe nëse dëshiron t’i jep konotacion edhe këtyre shprehjeve, atëherë nuk është problemi im.

Kryetari - Serbia, përmes rezolutës 1244 ka tentuar që të jetë vetëm “banorë” sepse Kosova është territor. Termi “qytetarë” është zyrtar dhe i bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kosova është shtet i qytetarëve, jo i banorëve. Të gjithëve iu drejtohem “Të nderuar qytetarë”, sepse ky term nuk ka të bëjë me atë a jeton në fshat apo qytet, por është nocion që gërshëton komponenten shtetërore. Për çfarëdo dyshimi të paraqitur në Raportin e ZKA-së, ekziston një institucion që quhet Njësia për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe nëse ata vlerësojnë se ky që e ka fituar tenderin dhe kinse komisioni nuk e ka vërejtur listën e nënshkruar, atëherë komisioni përgjigjet, respektivisht shefi i prokurimit.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues! Kryetar, ajo që nuk më pëlqej është që nuk është mirë të “gjuajmë” te zyrtarët tanë sepse shumë herë po mburremi me punën e mirë të tyre. Pa dashur ta luaj rolin e hetuesit, por ka gabime dhe lëshime dhe është herët gjithçka. Është mirë për qytetarët e Rahovecit që Raporti ka dalur i pamodifikuar, por brenda i ka disa gjëra jo të lavdërueshme! Nuk po gjykoj dhe nuk i njoh procedurat e prokurimit, kam konsultuar zyrtarë - shokë të prokurimit që kam, kurrë nuk jam marrë me këtë çështje dhe asnjëherë nuk kam qenë as në komision vlerësues në karrierën time, por më kanë thënë që momentin kur operatorit i mungojnë ndonjëri prej dokumenteve që përfaqësojnë kriter të prokurimit, procesi anulohet komplet! D.m.th nuk është komisioni ai që e matë peshën e dokumentit, në çoftëse

ka pasë inxhinier mungesë, është dashur të eliminohet procedura dhe të rishpallet nga fillimi. Te çështja e vonesave dhe te bërja e zotimeve të mjeteve pas pranimit të faturës, po e them publikisht se ky rekomandim do të të përsëritet vazhdimisht përderisa komuna ka obligime kontraktuale. Kur vetëvetiu kryhen punët pa mbulueshmëri financiare, operatori ta bie faturën dhe kur të dalin mjetet ia bën pagesën, është cikël që do të përsëritet. Një çështje tjetër që më la përshtypje dhe besoj që si kryetar komune duhet të merresh, është kontrata e hartimit të projekteve (e gjetura, A4). Është e ndarë në 7 kategori, secila e ka peshën e vet në bazë të çmimit. Te pjesa: Projektimi i urave, mbikalimeve, trotuareve etj... pesha e kontratës ka qenë 10%, d.m.th vetëm 10% e vlerës së kontratës për ura, mbikalime, trotuare. Çmimi për këtë lloj projektim është 3.08€, prej dallim prej tjerëve që më i larti është 1.73€. Rreth 1.45€ më shtrenjt sesa çmimi i dytë. Në vend se të përdoren 10% të shpenzimeve për këtë projektim, janë përdorur 61% të mjeteve për këtë pozicion të projektimit. Kjo nënkupton që nëse do të bëhej përshkrimi në fillim, ndoshta operatori tjetër do të dilte më i lirë sesa më i liri, sepse kjo e ka mundësuar vetëm që ndërrimi i pozicioneve ta mundësojë përfitimin më të madh të operatorit që e ka pasur kontratën për projektim. Konsultojë një inxhinier dhe një ekonomist sepse kjo e ka dëmtuar direkt kontratën, sepse nuk kanë guxuar më shumë se 10% ose 35.000€ të bëjnë projekte, e në realitet janë bërë 212.000€. E kam bindjen e plotë që ky operator ka mundur të jetë me çmim më të lartë sesa operatori më i lirë. Janë të gjetura "me kunj", raporti është i pamodifikuar, e në anën tjetër brenda ka gjëra që nuk do të kisha qejf asnjëherë t'i lexoja.

Kryetari – Jemi duke i adresuat të gjeturat me Zyrën e Prokurimit dhe USAID-in (që është partner). Ligji i prokurimit e thotë që operatori që është i përgjegjshëm me dokumentacion dhe gjithashtu më i liri, e fiton të drejtën. Çështja e akuzës ndaj zyrtarëve, askënd nuk e akuzova, por fatkeqësisht kryetari e ka për detyrë të kërkojë llogari prej komisionit të vlerësimit. Burim, nuk është e vertetë që pamja e jashtme është e mirë, ndërsa brendia është me "kunja". Realisht ka shkelje, por jo deri në atë masë që e dëmtojnë integritetin dhe dinjitetin e komunës. Në Raportet e shumicës së ministrive dhe disa komunave, ka situatë vertetë më problematike dhe në krahasim me të gjitha këto, raporti ynë mund të qëndrojë si më i miri.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues! Dëshiroj që para qytetarëve të komunës të shpreh shqetësimin në lidhje me gjetjet e ZKA-së, që kryesisht lidhen me parregullsitë në menaxhimin e punëve komunale. Problematikat që janë hasur mund të mos jenë shumë të rëndësishme, por vend për diskutim ka çdo herë. Unë edhe vitin e kaluar kam diskutuar për Raportin e Auditimit 2021, raport ky që nuk ka qenë i mirë. Kryetari nuk i ka pritur mirë këshillat, por uroj që përmirësime të ketë vazhdimisht. Fillimisht Raporti flet për parregullsitë në Prokurimin Publik, ku komuna vazhdimisht i shkelë dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore në fushën e prokurimit, duke iu mundësuar operatorëve ekonomik që të paguajnë sigurinë e ekzekutimit të kontratës në afat më të shkurtër sesa që parashihet. Rastin e kemi te projekti i ndërtimit të Sheshit Qëndror, një projekt shumë i rëndësishëm me vlerë të madhe, në këtë rast në vend të garancionit që i jepet për 3 vjet, komuna ia mundëson për 1 vit. Poashtu, komuna duke e ditur që për disa projekte nuk ka mjete buxhetore, nuk e bën zotimin e mjeteve dhe e fut komunën në borxhe duke krijuar shpenzime shtesë në dëm të buxhetit. Parregullsitë janë hasur edhe te ndërtimi i rrugës në Rahovec, nga rrotullimi deri në dalje të Rahovecit në vlerë prej 1.222.000€, ku është mundësuar dhënia e tenderit për një kompani pa staf të duhur profesional. Raporti i ZKA-së si problematikë i përmend edhe pagesat që bëhen edhe në procedurën e përmbartimit nga vendimet gjyqësore. Kjo është shqetësuese sepse është fakt që Zbatimi i kontratës kolektive deri më 22.11.2022 për komunën tonë është i obligueshëm dhe mendoj që komuna duhet të gjejë një zgjidhje që t'i shmanget këtyre pagesave enorme që e ngarkojnë buxhetin e komunës. Në këtë drejtim kërkoj nga kryetari i komunës në bashkëpunim me avokaturën komunale, t'i shfrytëzojë mundësitë ligjore që t'i shmangen pagesave të kamatës dhe shpenzimeve të procedurës sepse informatave që kam, gjykatat janë duke vendosur në shumicën e rasteve pa seancë gjyqësore. Problemi tjetër që përballet komuna është te vonesat në pagesa të obligimeve financiare, kjo ndodh sepse komuna hyn në projekte pa pasur buxhet. Papërgjegjësi komunale është edhe garancioni i punimeve në afat jo të duhur, ku rreth 4 kontrata publike janë dhënë në garancion një vjeçar, ndërsa është dashur të jepen për dy vjet.

Kryetari – Ato që i biseduam, besoni që ne jemi pajtuar me të gjeturat dhe jemi pajtuar me faktin që ka nevojë të hartohet një Plan i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe një grup punues. E thatë që këshillat nuk i marrim pasqyrë, pikërisht e falënderova kuvendin që falë kritikave këtu e kemi rritur angazhimin dhe përkushtimin tonë dhe për këtë arsye kemi pasur progres. Deri në fund të vitin, mendojmë që 80% të rekomandimeve do të zbatohen dhe jemi në hap të mirë, të suguri dhe mundësi e artë për të fituar grant nga granti i performancës.

Sejfullah Sejfullahu – E kam lexuar Raportin dhe e kam krahasuar me atë të vitit të kaluar dhe shihet që është kontrast. Bile, nuk e di sa ju kujtohet, vitin e kaluar pa ta propozuar edhe ta padisim Auditorin. Vlora Spanca sepse sipas jush ajo e ka bërë Raportin në mënyrë të padrejtë. Raporti është i mirë dhe kemi mundësi t'i fitojmë shumë lehtë 2 milion të grantit, nëse nuk i fitojmë, del që edhe këto gjetjet e vogla ka mundësi të na shkaktojnë probleme.

Kryetari – Unë i dhash opinionet që në fillim, duke thënë që kemi gjetje por edhe vlerësime pozitive. Ne e kemi fituar të drejtën për grant dhe kriteret e bazuar në ligj, sepse fjalia bazë që e vlerëson është që e kemi opinionin e pamodifikuar i pasqyrave vjetore financiare për Komunën e Rahovecit për vitin 2022. Vitin e kaluar, Vlora Spancën e kam takuar zyrtarisht dhe sot e kësaj dite mendojmë që n'a është bërë e padrejtë.

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues! Në emër të grupit e uroj ekzekutivin komunal për opinionin e pamodifikuar në Raportin Financiar të ZKA-së, poashtu e uroj edhe grupin punues që është marrë me adresimin e rekomandimeve dhe punën e bërë për vitin 2022. Ky raport paraqet gjendjen reale të Komunës së Rahovecit, veçanërisht në pjesën e pasqyrave financiare dhe janë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare. Po ndalem tek një pjesë shumë e rëndësishme që ka të bëjë me shpenzimin e buxhetit, tashmë është bërë traditë, në qeverisjen e kryetarit, Latifi, buxheti shpenzohet 95%. Pjesa tjetër ka të bëjë me progresin e zbatimit të rekomandimeve nga viti i kaluar, nga 14 sa kanë qenë në vitin 2021, 9 prej tyre janë zbatuar plotësisht. E kuptojmë që ka vend ende për përmirësim, në mënyrë që në raportet për vitet e ardhshme komuna jonë të jetë sa më mirë. Përkundër asaj që këtë vit raporti është i pamodifikuar, kërkoj një çasje edhe më serioze, në mënyrë që raporti për vitin 2023 të ketë sa më pak të gjetura.

Defrim Kafexhiu - Faleminderit kryesues! Meqenëse kemi një çasje me joseriozitet të theksuar të grupit të Aleancës, ku me një volum të rendit të ditës me 19 pika, nuk e shohin të arsyeshme të qëndrojnë në sallë, përkundër asaj që kjo seancë paguhet nga buxheti i komunës. Teksa për qështje të padobishme sikurse shkarkimi i kryesuesit, marrim pjesë të gjithë, atëherë ne si grup i LVV-së nuk e shohim të arsyeshme të qëndrojmë deri në fund të kësaj seance dhe po e lirojmë sallën shkaku i papërgjegjësisë të grupit të Aleancës.

Hasan Përboqi – Detyrohem t'i përgjigjem ish kryesuesit si shef i grupit të Aleancës, e para, këtu jemi të gjithë të barabartë. Një porosi për grupin e LVV-së, që për shtigje të gjata nuk jeni!

14. Shqyrtimi i Raportit nga Drejtoria e Arsimit rreth përfundimit të vitit mësimor 2022/2023;

Avni Morina – Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit, të gjithë të pranishëm. Në këtë raport janë të pasqyruara të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin edukativo-arsimor në komunën tonë, prej fillimit të vitit mësimor deri më 30 qershor të këtij viti. Viti shkollor ende nuk ka përfunduar sepse zakonisht përfundon me 31 gusht. Jemi munduar që të pasqyrojmë të gjitha aktivitetet zhvillimet, garat, rezultatet, projektet dhe sfidat që i kemi pasur që në fillim të vitit shkollor, duke përfshirë këtu edhe grevën në arsim, e cila shkaktoi një muaj të plotë mosmbajtje të mësimit. Nga testi i maturës që kanë marrë pjesë 408 maturantë, kanë kaluar 238 prej tyre dhe nuk kanë kaluar 170. Këta të fundit do t'i nënshtrohen afatit të dytë me 26 gusht. Raporti me të gjitha të dhënat i ka gjithsej 6 faqe material.

Burim Krasniqi – Fillimisht dua t'i jap vërejtje grupit të asambleistëve të Aleancës, është papërgjegjësi totale në raport me drejtorat e subjektit të vet politik, të cilët kanë pritur prej orës 10:00 të mëngjesit deri tani. Në çoftëse vazhdohet me këtë papërgjegjësi, LDK, nuk do të qëndrojë më që ta sigurojë kuorumin. Është mirë që së paku 80% e secilës parti të jenë prezentë, për t'i dhënë kuptim asamblesë komunale. Te raporti, të lutem, të na përcjellësh me statistika: Sa nxënës, sa është nota mesatare, mungesa e nxënësve, mungesat e arsimtarëve-profesorëve etj... që ndoshta mund të kemi ndonjë sugjerim që mund të ketë ndikim në të mirë të DKA-së dhe komunës në funksionim të arsimit në Komunën e Rahovecit.

Hasan Përboqi – Në fakt e kam një sqarim për shefin e grupit të asambleistëve të LDK-së, momentalisht prej 15 asambleistëve, AAK i ka 10 të pranishëm. Përgjegjësi para qytetarëve kemi të gjithë njëjtë. E mirëkuptojmë çdo njërin, por nuk mund t'i kesh nën menaxhim si gjashtë, si pesëmbëdhjetë. E falenderoj çdo anëtarë që ka qëndruar deri në këtë kohë dhe gjithashtu duhet të respektohet besimi që e kemi marrë prej qytetarëve.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues! Kisha kërkuar prej teje ta respektosh rregulloren dhe radhën e përfaqësisë së diskutimeve. Nga drejtori i Arsimit, dëshiroj të na tregojë se cilat synime i ka arritur, a kanë përfundur tri qerdhjet publike elektrike, nëse jo, pse? A është investuar në efikasitet të energjisë në objektet shkollore, nëse jo, pse? Cilat janë veprimet e ndërmarra në përmirësimin e performancës së sistemit arsimor në komunën tonë? Si janë menaxhuar shkollat? Mungesat e nxënësve dhe mësimitdhënësve?...

15. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

Berat Duraku – Faleminderit kryesues! Përhëndetje për kryetarin, kolegët, asambleistët. Para jush e keni edhe materialin e informatës për aktivitetet që kanë ndodhur në drejtorinë e Bujqësisë në periudhën janar-qershor. Me plan të punës është kërkuar që në informatë të ketë kryesisht të dhëna për aplikimin e fermerëve tanë për subvencione, por ne jemi zgjeruar duke paraqitur edhe informata të ndryshe për aktivitetet kryesore. Këtë vit fat i keq ka qenë që kushtet klimatike nuk kanë qenë në favor të fermerëve dhe si rezultat i kësaj kemi dëme të konsiderueshme nga lagështia e tepërt. Sektori i lavërtarisë ka rritje të sipërfaqes dhe kjo ka ndikuar në rritjen e subvencione në kulturën e grurit, kur i kemi edhe 707ha më shumë. Te kultura e specit, si pasojë e kushteve klimatike, krahasuar me vitin e kaluar këtë vit 68 ha i kemi më pak. 5.7 milion është vlera e subvencioneve që do ta përfitojnë fermerët e Komunës së Rahovecit, 270.000€ më shumë sesa vitin e kaluar.

Lirigzon Kastrati – Po ndërlidhem me çështjen e vërshimeve dhe dëmeve në bujqësi. Para disa jave komuna i ka njoftuar qytetarët për vlerësimet e bëra nga breshëri për vreshtat. Kur do të kompenzohen këto mjete dhe a janë dorëzuar listat për raportim në Ministri?

Burim Krasniqi – Më ka lënë përshtypje se të gjitha shënimet janë bazë të aplikacioneve për subvencione. Besoj që Drejtoria e Bujqësisë duhet t'i bëjë edhe matjet dhe konstatimet dhe analizat e veta.

Sejfullah Sejfullahu – Nuk dua të flas shumë për raportin, dua ta shfrytëzoj rastin për një apel dhe t'i ftoj të gjithë asambleistët e që këta ta përdorin ndikimin e tyre që me 5-6 gusht në Krushë të Madhe organizohet "Agro-Festa" dhe janë të ftuar në Krushë të Madhe, pozitë dhe opozitë.

Berat Duraku – Po Lirigzon, me 16 qershor e kemi formuar komisionin dhe duke u bazuar në udhëzimin administrativ e kemi hap edhe njoftimin duke i ftuar fermerët t'i bëjnë kërkesat për vlerësimin e dëmeve. Deri më tani i kemi pranuar 360 kërkesa dhe në dy javët e para të muajit gusht, raporti do të dorëzohet në Ministri. Burim, Drejtori e Bujqësisë ka data bazë të të dhënave pothuajse për secilin fermer, por të dhënat e kultivimit ndërrojnë nga viti në vit.

16. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;

Kryetari – Për dallim nga Raporti i Arsimit, Raporti i Shëndetësisë ka bukur shumë statistika. Gjatë periudhës janar – qershor 2023 janë kryer gjithsej 55.117 shërbime. Është shtuar numri i punëtorëve shëndetësorë. Ka filluar renovimi i jashtëm i QKMF-së. I kemi blerë edhe dy autoambulanca tjera për nevojat e QKMF-së, njëra shkon në Krushë dhe tjetra në qytet. Falë vizitave shtëpiake për nena dhe fëmijë, është afitur një grant nga UNICEF-i, një veturë të re për nevojat e QKMF-së. Nga muaji maj është funksionalizuar Qendrën e Mjekësisë Familjare edhe të dielave, me orar 07:00-21:00.

17. Shqyrtimi i Informatës mbi realizimin e Planit për Mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike në Komunën e Rahovecit;

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues! Përhëndetje për të gjithë anëtarët e kuvendit. Në raport kemi shfaqur statistika dhe përveç kësaj ju informoj zyrtarisht që i kemi tri kontrata për mirëmbajtjen e hapësirave publike duke përfshirë edhe lapidaret, varrezat e dëshmorëve dhe varrezat civile në të gjithë territorin e Komunës së Rahovecit.

Lirigzon Kastrati – Te çështja e mirëmbajtjes së varrezave, në fshatin Hoçë e Vogël janë pastruar, por një pjesë jo dhe thash ta rikujtoj.

Burim Krasniqi – E kam një pyetje interesante, varrezat në zonën urbane (99.921.5m²), po më intereson këtë 05 m² me çka e matë? vetëm që raporti të jetë më bindës apo si!?

Përparim Krasniqi – Matjet janë të bërë nga DEMOS-i në bashkëpunim me Komunën e Rahovecit. Statistikat janë të sakta, nuk janë të shpikura. Te Lirigzoni, rreth pjesës të varrezat që nuk është pastruar, sepse për momentin aty nuk ka varreza dhe kompania nuk e ka parë të nevojshme të pastrohet.

18. Shqyrtimi i Informatës mbi realizimin e Planit të punës së Zyrës së Prokurimit, janar – qershor 2023;

Astrit Mullabazi – Faleminderit kryesues! Gjatë periudhës raportuese gjashtë mujore të punës së Zyrës së Prokurimit, ju njoftojmë se deri tani kemi proceduar 45 aktivitete të prokurimit me vlerë të parashikuar 11.642.286.02€. Janë nënshkruar 24 kontrata me vlerë 1.102.000€. Një aktivitet është në procedurë të ankesës dhe është ritenderuar, bëhet fjalë për mbikëqyrjen e investimeve kapitale, ndërsa 20 aktivitete tjera janë në procedura të prokurimit në vlerësim. Një sqarim rreth raportit të ZKA-së, sa i përket vlerësimit joadekuat në kuadër të Zyrës së Prokurimit, mund ta verifikoni edhe në web-faqen e Komunës së Rahovecit, që në dosjen e tenderit të një procedure të prokurimit është kërkuar vetëm Plani i Menaxhimit të Trafikut i përgatitur nga inxhinieri i komunikacionit. Në dosjen e tenderit nuk është kërkuar as diploma e inxhinierit të komunikacionit e as cv-ja. Sqarimi tjetër është që kemi kërkuar ISO-standarte nga kompanitë dhe procedurat e prokurimit janë zhvilluar konform ligjit të prokurimit publik.

Burim Krasniqi – I kam dy çështje: Vlera e parashikuar e aktiviteteve, vlera prej 11.642.286.02€ a është për këto aktivitete apo për tërë vitin? Nëse është e paraparë vetëm për këtu 24 aktivitete dhe komplet kontratat janë 4.357.000€, atëherë vlera e planifikuar është 60% më e madhe sesa vlera e kontratave të lira, d.m.th një huqje e madhe. E dyta, keni mospërputhje në raportim, raporti financiar dhe informata juaj. Sipas raportit financiar, planifikimi është 11 milion e 840 mijë € dhe sipas jush 11 milion e 650 mijë € (dallimi është rreth 200.000€). Tjetër, kontratat e lidhura sipas raportit të financave është 2.2 milion, sipas jush është 4.3 milion (dallimi mbi 2 milion).

Astrit Mullabazi – Për 45 aktivitete të prokurimit me urdhëresë të kryetarit të komunës e kapin vlerën e paraparë 11 milion e 642 mijë €, prej këtyre janë nënshkruar vetëm 24 kontrata me vlerë 1 milion e 102 mijë €, kurse 21 aktivitete të prokurimit brenda kësaj vlere nuk janë të nënshkruara kontratat. Njëra prej tyre është në procedurë të vlerësimit, ndërtimi i qendrës rinore dhe kulturore me vlerë 3.5 milion €. Sa i përket urdhërbljes, këtë informatë e kemi nga sistemi i freebalances, ku deri më tani Zyra e Prokurimit ka proceduar 758 pagesa me vlerë 4.357.112.66€.

19. Shqyrtimi i Raportit 6 mujor të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe.

Senad Mullaavda – Përshëndetje për kryetarin, kryesuesin, drejtorët dhe juve kuvendarë të nderuar! Para jush e keni Raportin 6 – mujor të punës të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe. Ky këshill mbledhjet i mbanë në bazë Planit të Punës i cili është miratuar në kuvend, gjithashtu në raport janë të paraqitura pikat e shqyrtuara dhe detajet tjera.

Kryesuesi – A kemi komente ose sugjerime në lidhje me këtë pikë?... Nëse jo, atëherë po e përmbylлим seancën e shtatë, duke iu falënderuar për qetësinë dhe maturinë, shihemi në seancat tjera.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I

Arbër Zenuni



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **12.7.2023 (e martë)**, me fillim në orën **10:15**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **zt. Defrim Kafexhiu**. Në fillim konstatoi se të pranishëm janë **28** kuvendarë.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë, përfaqësues të mediave, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit, kjo është një seancë e jashtëzakonshme e thirrur nga shumica e kuvendarëve. Për këtë mbledhje është propozuar një pikë e rendit të ditës.

REND DITE

1. Votëbesimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Kryesuesi – Atëherë po e vendosim në votim miratimin e rendit të ditës, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 16 vota për, 11 kundër dhe një abstenim, miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues! Përshëndetje qytetarë të Komunës së Rahovecit, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë, media. E kemi ftuar këtë seancë të jashtëzakonshme sepse kështu e ka paraparë Ligji për Vetqeverisje Lokale dhe jo pse gjendja në komunën tonë është e jashtëzakonshme. E kemi ndërmarrë një nismë për votëbesimin e kryesuesit aktual të kuvendit, jo pse dikush ka diçka personale me të, por për ta dëshmuar përkushtimin tonë që kuvendi i komunës mund të funksionojë shumë më mirë sesa ka funksionuar deri tani. Në këtë kuvend janë marr shumë vendime të rëndësishme, janë miratuar shumë akte nënligjore, janë diskutuar shumë çështje dhe janë trajtuar shumë tema me rëndësi në të mirën e qytetarëve tanë, sepse në fund, të gjithë jemi të zgjedhur nga besimi i qytetarëve. Në rrethanat që jemi sot, është krijuar një shumicë politike e cila ka vlerësuar se janë krijuar mundësitë e reja për të shkuar edhe më përpara, duke pasur funksionim më të mirë me marrëdhënie më të qëndrueshme në programin qeverisës (të fitusit të zgjedhjeve lokale të vitit 2021). Me këtë frymë kemi ardhur në përfundim që kjo përpjekje është për ta mundësuar një zhvillim normal politik i cili rrit edhe më shumë rolin dhe përkushtimin e kuvendit me vendimmarrje të përgjegjshme dhe pa vonesa. Ka ardhur koha për votëbesimin e kryesuesit, janë pjekur kushtet për këtë ndryshim. Kemi mbledhur 16 nënshkrime dhe ju ftoj që të votoni për lirin e kryesuesit nga detyra. Kjo kërkesë është demokratike sepse kemi një shumicë legjitime. Ky është një veprim politik dhe po bëjmë një veprim të nevojshëm dhe të dobishëm. Duke u mbështetur në argumentet e sipërthëna dhe mundësitë reale që kemi paqë vetes si shumicë politike, i ftoj të gjithë anëtarët e kuvendit komunal që t'i bashkohen nismës tonë.

Leonard Morina – I nderuar kryesues, drejtorë, anëtarë të kuvendit, media, qytetarë. Sot jemi në një seancë të jashtëzakonshme e thirrur nga pozita, duke shprehur mosdurim ndaj vlerave profesionale dhe intelektuale që i zotëron **zt. Defrim Kafexhiu**. Për ju delegatë nënshkrues të këtij mocioni, mendoj që komuna jonë ka shumë prioritetë më urgjent sesa çështja e shkarkimit të kryesuesit. Kryesuesi, gjatë këtij mandati ka kryer punën në përputhshmëri me rregulloren e kuvendit dhe brenda kompetencave që ia lejon ligji. Kjo i bie që vet fakti që deri më tani kryesuesi që nuk ishte nga radhët e AAK-së, paraqet një gjendje të jashtëzakonshme për ju. Këtu pajtohem sepse qysh para dy viteve keni filluar procesin e shkarkimit të kryesuesit, duke joshur asambleistë nga subjektet tjera përmes favoreve të ndryshme që t'ju bashkëngjiten juve si sasi, por jo si cilësi. Kërkoj nga delegatët nënshkrues të kërkesës së këtij mocioni të tregojnë se në cilat raste kryesuesi e ka shkelur rregulloren. Kjo është një mënyrë klasike për të kontrolluar gjithçka! Edhe kuvendit si organ më i lartë në nivel komunal. Të nderuar asambleistë, ju ftoj që përmes votës ta refuzoni këtë iniciativë për këtë pangopësi politike dhe ju siguroj që po të kishte bërë shkelje kryesuesi, unë si shef do ta inicioja procedurën e shkarkimit, por përkundrazi, kryesuesi është një profesionist i vërtetë dhe i paanshëm në vendimmarrje.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues! I nderuar ekzekutiv, kolegë anëtarë të kuvendit, qytetarë, media. Seanca e thirrur për sot në fakt nuk i shërben interesit të qytetarëve. Kjo seancë është thirrur thjesht për interesa, inate dhe pazare të pushtetit. Për mua është shumëpak e rëndësishme se kush do të jetë kryesues nesër, por më shqetëson fakti që qytetarët e perceptojnë punën e këtij kuvendi për interesa të ngushta politike. Në demokraci është normale që dikush të udhëheq me ekzekutivin dhe dikush tjetër me legjislativin (kuvendin). Si duket pushtetit komunal nuk i mjafton qeverisja të cilën dëshiron ta shtrijë edhe në asamble, duke e shtypur vullnetin e qytetarëve të komunës sonë. Këto veprime e cenojnë rëndë rendin e punës të kësaj asambleje komunale, si institucion i vetëm në të cilin merren vendime të ndryshme në favor të qytetarëve.

Sejfullah Sejfullahu – Nuk dua të ju drejtohem, “i nderuar ky, i nderuar ai” sepse më duket nuk na ka mbetur fare moral në këtë kuvend. Si Sejfullah Sejfullahu po flas, për dy vite jemi familjarizuar në këtë kuvend, duke mos anashkaluar edhe kritikën dhe mosmarrëveshjet. Sot, Rahoveci e ka një fitore të madhe, projekti kryesor për shkarkimin e kryesuesit po realizohet. Kam nisur ta bëj një skenar, për ngjarjet në Kosovë pas luftës, prej rezistencës së Presidentit Rugova dhe Ukshin Hotit deri te zhvillimet që po ndodhin, por në fund më ka humbur vullneti duke i parë seancat e fundit këtu te ne, me sarkazëm, por turp! Defrimi po më dhimbet që është në LVV, në PDK nuk të kisha sugjeruar se edhe për ne nuk po dihet, as mua! Çdo kush i ka votat e veta. Kryesues po bëhet Arbëri, prej një djali të mirë, po vie një më i mirë. Arbër, baca duhet me ta dhënë votën, nuk e di a duhet a jo! Ndoshta edhe nuk ta jap, po nëse fiton, do të them të më ftosh për një kafë. Arbër, edhe nëse ta jap votën, ti nuk do të besosh, kështu që jam në pozitë të palakmueshme!

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues! Unë kërkoja që thirrësi i mocionit ta thotë arsyetimin e thirrjes së kësaj seance dhe është për keqardhje kur në arsyetim nuk kishte asnjë vërejtje. Mocioni ka arsyetim, bazë dhe qëllim të përmirësimit përmes një ndryshimi. Këtu qëllimi ka të bëjë me kënaqjen e apetiteve të kryetarit që kur të thotë ndale seancën, me ndalë, kur t’i thotë dikujt “ta dredhi krytë” mos ta incizojë kamera, kur t’i thotë dikujt “kris edhe plumi” mos ta incizojë telefoni dhe kur t’i thotë dikujt unë përdori edhe mjete demokratike “shantazhin” të jetë në heshtje. Nuk ka të bëjë këtu me mospunë të asamblesë komunale. Nëse e marrim rregullore e kuvendit dhe e shikojmë minutazhën e kryetarit, me përgjegjësi të plotë them që i tejkalohet. Në asamble ka edhe gjuhë kërcënuese, përtej asaj ofenduese. Konsideroj që asambleja komunale gradualisht po rëshqet dhe ndoshta në të ardhmen me një funksionim më pak se 50%. Është për keqardhje kur e shohim që besimin e qytetarëve e kthejmë në shërbim të individit. Po ndodh ajo që ia ka marrë dorën tregtisë (jep diçka, merr diçka). Për keqardhje është “pazar” dhe nuk lexohet ndryshe. Kushdo që vjen kryesues, suksese! Po them që do të jetë kryesues i turpit në zhvillimin e dy viteve tjera të asamblesë komunale.

Sinan Kryeziu – Faleminderit kryesues! U detyrova ta marr fjalën për faktin që ish shefi im, Leonard Morina më sulmoi me dashje, duke thënë që kryetari ka marrë sasi, por jo cilësi. E para e punës, ai ka qenë bartës i listës, e unë me motër kemi shkuar tutje bashkë. U fol është për pazare, herën e parë e kemi pasur një pazar politik me PDK-në (e kemi marrëveshjen me shkrim).

Kryesuesi – Atëherë përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit, anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë, media, përfaqësues të organizatave, zyrtarë komunalë. Sot në këtë seancë për shkarkim po ndihem më mirë sesa në seancën e zgjedhjes sime si kryesues. Po ndihem më lehtë se më largohet përgjegjësi ndaj jush dhe më rritet më shumë përgjegjësi ndaj banorëve të komunës sonë. 22 dhjetor 2021 u mbajt seanca për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit komunal. Në atë ditë, gjatë dy seancave dhe pas pesë raundeve të votimit, u zgjedha kryesues me 16 vota. Tani është nënshkruar një kërkesë për seancë të jashtëzakonshme për votëbesimin e kryesuesit nga 16 anëtarë, me disa arsye të zbehta edhe pse nuk ka arsye për shkarkim. Aleanca në kuvend, në zgjedhjet e vitit 2021 fitoi 12 mandate. Dhimbja e fortë për fitoren e opozitës, me 22 dhjetor rezultoi me oferta të parezistueshme për Shqipe Kryeziu, e cila u thye e para. Ato pak parime që i kishin mbetur në fund të karrierës në Vetëvendosje, u shlyen për pak pushtet brenda Aleancës, apo jo kryetare e gruas së Aleancës?... Seancat e rregullta filluan në vitin 2022 dhe kështu filloi funksionimi normal i kuvendit komunal. Për kryetarit diktat ishte i vështirë i pranueshëm vullneti i qytetarëve, vullneti i shumicës – shumiva e opozitës. Pamundësia e tij për ta udhëhequr seancën përmes kukullës moderuese eskalonte situatën e shfaqte zemërim brutal ndaj anëtarëve të kuvendit. Kryetar që nuk njeh rregullore, statut apo ligj, ndoshta edhe i njeh por asnjëherë nuk i respekton. Ishte seanca e tretë e kuvendit ku kryetari pa respekt e me shfrenim ia “mësyn” foltores dhe ia merr fjalën atij që duhet t’ia jepte. “S’ka me lon guri pa lëvizë, s’ka me lon guri pa

